



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 57

Tiranë – E mërkurë, 24 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11173, datë 16.4.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 4497
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 17.4.2019	Për një shtesë në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar..... 4497
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 17.4.2019	Për disa shtesa në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar..... 4498
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 17.4.2019	Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2019, për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave..... 4500
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 217, datë 17.4.2019	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Polonisë, për punësimin në punë fitimprurëse të anëtarëve të familjes së një anëtarë të një misioni diplomatik apo konsullor..... 4501
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 17.4.2019	Për transferimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pasurisë me nr. 3/20, me vendndodhje në zonën kadastrale 8340..... 4503

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 17.4.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 827, datë 11.12.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e kodimit dhe strukturën e numrit të identitetit të shtetasve”.....	4505
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 220, datë 17.4.2019	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Memaliaj, të pronës me numër rendor 264, dhe për një shtesë në vendimin nr. 974, datë 30.9.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Memaliaj, të qarkut të Gjirokastrës”.....	4506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 221, datë 17.4.2019	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, të pronës me emërtimin “Bashkia” me vendndodhje në zonën kadastrale 8605.....	4507
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 222, datë 17.4.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1086, datë 28.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Librazhd, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.....	4508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 17.4.2019	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), dhe KfW Frankfurt am main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza III.....	4509
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 224 datë 17.4.2019	Për miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit “Ndërtimi i bulevardit verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës”, të ratifikuar me ligjin nr. 150/2013.....	4513
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 17.4.2019	Për dhënie ndihme financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për qeverinë e Republikës së Francës, për rindërtimin e Katedrales “Notre-Dame” në Paris.....	4514
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 17.4.2019	Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit.....	4514
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 17.4.2019	Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare.	4515
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 17.4.2019	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e ndërsjellë të patentë shoferëve/lejeve të drejtimit.....	4517
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 233, datë 17.4.2019	Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve, të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit e të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve.....	4530

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 17.4.2019	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 19.5.2010; nr. 378, datë 25.5.2016; nr. 529, datë 20.7.2016; nr. 563, datë 29.7.2016; nr. 230, datë 21.3.2017; nr. 711, datë 1.12.2017; nr. 712, datë 1.12.2017; nr. 713, datë 1.12.2017; nr. 291, datë 21.5.2018; nr. 294, datë 21.5.2018; nr. 432, datë 11.7.2018; nr. 433, datë 11.7.2018; dhe nr. 737, datë 12.12.2018, “Për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”.....	4536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 17.4.2019	Për miratimin e rregullores “Për pulpën e frutës së thatë baobab, si përbërës i ri ushqimor”.....	4548
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 237, datë 17.4.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4549
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 238, datë 17.4.2019	Për emërimin në detyrë të kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.....	4549
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 178, datë 18.4.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Gjirokastrë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4550
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 179, datë 18.4.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4552
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 180, datë 18.4.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4554
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 181, datë 18.4.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4556

**DEKRET**

Nr. 11173, datë 16.4.2019

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Flavia Shyqyri Guri
2. Musano Fatmir Deliu
3. Ervis Bashkim Gina
4. Herina Hektor Belortaja
5. Sidrit Ylli Janbelli
6. Alma Petrit Azizaj
7. Erola Agron Seitaj
8. Blerina Ilirian Aliaj
9. Shpëtim Kadri Tafaj
10. Erind Shpëtim Tafaj
11. Albi Shpëtim Tafaj
12. Klotilda Dhimitraq Ballgjini (Gërmau)
13. Gerald Altin Ballgjini
14. Altin Murat Ballgjini
15. Elona Dilaver Arifi (Elezi)
16. Sofi Florim Arifi
17. Jon Florim Arifi
18. Flutra Mynir Sokoli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 213, datë 17.4.2019

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE
TË NËPUNËSVE TË DISA
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas lidhjes I/10, të vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshilli i Ministrave, të ndryshuar, shtohet lidhja I/11, “Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë, për punonjësit mbështetës të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për vitin 2019, dhe të fillojnë nga momenti i emërimit të punonjësve në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



Lidhja I/11

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës të
Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë**

Nr.	POZICIONI	KLASA
1.	Shofer i kryetarit të KLGJ-së. Shofer i kryetarit të KLP-së. Teknik mirëmbajtjeje. Magaznier.	VII
2.	Shofer i anëtarit të KLGJ-së. Shofer i anëtarit të KLP-së. Shofer-korrier.	VI
3.	Nëpunës informacioni. Shoferë të tjerë.	V
4.	Punonjës pastrimi.	III

**VENDIM
Nr. 214, datë 17.4.2019**

ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

a) në fund të pikës 1/1 shtohen emërtesat “Këshilli i Lartë Gjyqësor” dhe “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”.

b) në pikën 5, pas fjalëve “... Stenograf, regjistruar audio në Kryeministri ...” shtohen fjalët “... dhe “Specialist redaktor në Kuvendin e Shqipërisë”...”.

c) pas pikës 7/1 shtohet pika 7/2, me këtë përmbajtje:

“7/2. Nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr.4/2/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr.4/2/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe të fillojnë nga:

a) momenti i transferimit apo emërimit të funksionarëve dhe nëpunësve, për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë;



b) momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe

Lidhja nr. 4/2/a

Nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Drejtor i kabinetit të kryetarit të KLGJ-së. Drejtor i kabinetit të kryetarit të KLP-së.	I-a	1
Këshilltar në kabinetin e kryetarit të KLGJ-së.	Barazohet në pagë me zëvendësministrin	
Këshilltar në kabinetin e kryetarit të KLP-së.	I-b	
Ndihmës në kabinetin e kryetarit të KLP-së.	III-a	1
Sekretar i kryetarit të KLGJ-së. Sekretar i kryetarit të KLP-së.	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	

Lidhja nr. 4/2/b

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Sekretar i Përgjithshëm.	I-a	1
Drejtor Departamenti.	I-b	1
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme. Drejtor Njësie. Nëpunës në njësinë përgjegjëse për vlerësimin e profesionalizimit dhe etikës së gjyqatrevë për vettingun në KLGJ.	II-a	1
Këshilltar i komisioneve të përhershme në KLGJ. Këshilltar në departamentin/njësinë përgjegjëse për shërbimet ligjore në KLP. Drejtor Drejtorie.	II-b	1
Përgjegjës/Shef Sektori.	III-a III-a/1	1
Specialist.	III-b	1 ose 2
Specialist.	IV-a IV-b	1 ose 2 ose 3



VENDIM
Nr. 216, datë 17.4.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT
2019, PËR BASHKËSITË FETARE, QË
KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE
ME KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin, nga buxheti i shtetit, të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit prej 109 000 000 (njëqind e nëntë milionë) lekësh, nga buxheti i vitit 2019, e miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, të përdoret, si më poshtë vijon:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 31 824 000 (tridhjetë e një milionë e tetëqind e njëzet e katër mijë) lekë, të ndarë në:

i. 11 544 000 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 74 (shtatëdhjetë e katër) punonjës të administratës;

ii. 20 280 000 (njëzet milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 130 (njëqind e tridhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 25 740 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë në:

i. 20 592 000 (njëzet milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 132 (njëqind e tridhjetë e dy) punonjës të administratës;

ii. 5 148 000 (pesë milionë e njëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e

pagës minimale buxhetore për 33 (tridhjetë e tre) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 25 740 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë në:

i. 6 240 000 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 (dyzet) punonjës të administratës;

ii. 19 500 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 125 (njëqind e njëzet e pesë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 25 696 000 (njëzet e pesë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të ndarë në:

i. 4 056 000 (katër milionë e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 26 (njëzet e gjashtë) punonjës të administratës;

ii. 14 640 000 (katërmëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë, për ndërtimin e Teqesë së Elbasanit;

iii. 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore, me qendër në Tiranë, dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit. Shuma do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë – preventivat e paraqitura prej saj në kërkesën e vitit 2019, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur.

2. Kalimi i fondit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të bëhet njëherësh, brenda muajit prill të vitit 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**VENDIM**

Nr. 217, datë 17.4.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË POLONISË, PËR
PUNËSIMIN NË PUNË FITIMPRURËSE
TË ANËTARËVE TË FAMILJES SË NJË
ANËTARI TË NJË MISIONI
DIPLOMATIK APO KONSULLOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Polonisë, për punësimin në punë fitimprurëse të anëtarëve të familjes së një anëtari të një misioni diplomatik apo konsullor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË POLONISË
PËR PUNËSIMIN NË PUNË
FITIMPRURËSE TË ANËTARËVE TË
FAMILJES SË NJË ANËTARI TË NJË
MISIONI DIPLOMATIK APO KONSULLOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Polonisë, në vijim referuar si “Palët”,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

**Autorizim për të ndjekur punësim
fitimprurës**

Anëtarët e familjes që janë pjesë e familjes së anëtarit të misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Polonisë dhe anëtarët e familjes që janë pjesë e familjes së anëtarit të misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Polonisë në Republikën e Shqipërisë, do të autorizohen, mbi baza reciproke, për t'u angazhuar në një punësim fitimprurës në shtetin pritës, në përputhje me ligjin e atij shteti dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2**Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1) “Punësim fitimprurës” do të thotë çdo formë punësimi tjetër me pagesë, si të vetëpunësuar ose si punonjës, duke përfshirë trajnimin profesional ose përmbushjen e një funksioni në bordin e një personi juridik që kryen veprimtari biznesi.

2) “Një anëtar i një misioni diplomatik apo posti konsullor” do të thotë një punonjës i Shtetit dërgues që kryen funksionet e një agjenti diplomatik, nëpunësi konsullor ose anëtar i personelit administrativ dhe teknik të misionit diplomatik apo të postit konsullor në shtetin pritës, në përputhje me përcaktimet e përfshira në nenin 1 shkronja “e” dhe “f” të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961 dhe në nenin 1 paragrafi 1, shkronja “d” dhe “e” të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të 24 prillit 1963, i cili nuk është shtetas i shtetit pritës dhe nuk e posedon të drejtën e qëndrimit të përhershëm në të:

3) “Anëtar i familjes” nënkupton personin e mëposhtëm që është pjesë e familjes dhe i varur nga një pjesëtar i misionit diplomatik apo postit konsullor të Shtetit dërgues:

a) bashkëshort/e;

b) fëmijë nën 21 vjeç;

c) fëmijë nën 25 vjeç, i cili ndjek me kohë të plotë studimet në një institucion arsimor pas shkollës së mesme;



d) fëmijë me paaftësi fizike ose mendore që është i paaftë për t'u kujdesur për veten e tij/saj.

Neni 3 Procedurat

1. Nëse një anëtar i familjes dëshiron të angazhohet në një punë fitimprurëse në Shtetin pritës, Ambasada e Shtetit dërgues duhet të paraqesë një kërkesë të përshtatshme me shkrim pranë Protokollit Diplomatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shtetit pritës.

2. Kërkesa e përmendur në paragrafin 1 duhet të identifikojë anëtarin e familjes, i cili dëshiron të angazhohet në punë fitimprurëse në shtetin pritës dhe duhet të përmbajë një përshtatshëm të shkurtër të pozicionit që ai/ajo synon të zërë, informacion në lidhje me punëdhënësin potencial dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga autoritetet kompetente të shtetit pritës, në përputhje me ligjin e tij të brendshëm.

3. Protokollu diplomatik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shtetit pritës, pas konfirmimit se anëtari i familjes në fjalë i plotëson kushtet e shtjelluara në këtë Marrëveshje, do të informojë Ambasadën e Shtetit tjetër, sa më shpejtë që të jetë e mundur, se anëtari i familjes në fjalë mund të angazhohet në punësim fitimprurës në territorin e Shtetit pritës.

4. Anëtari i familjes do të përjashtohet nga detyrimi për të marrë një leje punësimi në punë fitimprurëse në shtetin pritës, përveç lejes së parashikuar në paragrafin 3.

Neni 4 Imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ

Nëse anëtarë të anëtarit të familjes, gëzojnë imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ i Shtetit pritës në përputhje me Konventën e Vjenës, 18 prill 1961, mbi marrëdhëniet diplomatike apo me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, ose çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare të ratifikuar nga Palët, ky imunitet nuk do të zbatohet lidhur me çdo veprim apo mosveprim në lidhje me punësimin fitimprurës.

Neni 5 Imunitet nga juridiksioni penal

Nëse anëtarët e familjes, të autorizuar për t'u angazhuar me punë fitimprurëse, gëzojnë imunitet ndaj juridiksionit penal në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplommatike të vitit 1961, ose ndonjë marrëveshje tjetër ndërkombëtare në fuqi të ratifikuar nga Palët:

a) Shteti dërgues do marrë në shqyrtim seriozisht çdo kërkesë të Shtetit pritës për heqjen e imunitetit të juridiksionit penal të anëtarit të varur nga familja, akuzuar për kryerjen e një krimi, ose në lidhje me një veprim apo mosveprim që rezulton në përgjegjësi penale në lidhje me punësimin fitimprurës të personin nën varësi përveçse në rrethana të veçanta në të cilat shteti dërgues konsideron se heqja dorë është kundër interesave të tij. Kur imuniteti nuk është hequr anëtari i familjes do të humbas të drejtën për punësim fitimprurës dhe do t'i kërkohej të lërë territorin e Shtetit pritës.

b) Heqja e imunitetit ndaj juridiksionit penal nuk do të kuptohet se mund të zgjatet deri në vuajtjen e një dënimi, për të cilin qëllim do të kërkohej një dokument i veçantë i heqjes dorë. Në raste të tilla, Shteti dërgues do të studiojë seriozisht heqjen e këtij imuniteti të dytë.

Neni 6 Regjimet fiskale dhe sigurimet shoqërore

Anëtari i familjes i angazhuar në punë fitimprurëse do t'i nënshtrohet dispozitave për tatimin mbi të ardhurat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në fuqi në Shtetin pritës në lidhje me çdo çështje që ka të bëjë me angazhimin në punësim fitimprurës në këtë shtet.

Neni 7 Njohja e kualifikimeve

1. Kjo Marrëveshje nuk e lejon një anëtar të familjes për t'u angazhuar në punë fitimprurëse në pozicione që sipas ligjit të brendshëm të shtetit pritës mund të mbahen vetëm nga shtetasit e atij shteti.

2. Kjo Marrëveshje nuk parasheh mundësinë që anëtarët e familjes të kërkojnë njohje



automatike të kredencialeve profesionale të tyre, titujve shkencorë dhe/ose kualifikimeve të tjera. Njohja e tyre do të kryhet në përputhje me ligjin e brendshëm të shtetit pritës.

Neni 8

Ndërprerja e autorizimit

1. Ambasada e Shtetit dërgues do të informojë protokollin diplomatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shtetit pritës në lidhje me çdo ndryshim në statusin e anëtarit të familjes të angazhuar në punë fitimprurëse.

2. Leja për angazhim në punë fitimprurëse nga ana e anëtarit të familjes, të parashikuar në nenin 3 paragrafi 3, do të jetë e vlefshme deri në ditën:

1) kur një anëtar i familjes humbet statusin e tij/saj, në përputhje me nenin 2, pika 3; ose

2) e përfundimit apo mbarimit të kontratës së punës së anëtarit të familjes apo kontratë tjetër për angazhimin në punë fitimprurëse ose

3) e mbarimit të detyrës në shtetin pritës të anëtarit të misionit diplomatik apo postit konsullor nga i cili varet statusi i atij anëtarit të familjes.

3. Ndryshimi në punësim fitimprurës nga ana e anëtarit të familjes kërkon leje të re në përputhje me procedurat dhe rregullat e parashikuara në nenin 3.

Neni 9

Ndryshimet

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me pëlqimin e ndërsjellë të palëve, të formuluar në protokolle të veçanta, si pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje, që do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 11.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të negociatave të drejtpërdrejta midis palëve.

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të njoftimit të fundit në të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pakufizuar.

3. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje përmes njoftimit nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të përfundojë pas 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së njoftimit të përfundimit.

Bërë në Varshavë, më 28. 2., dy mijë e 19 në dy ekzemplarë, secili në gjuhën shqipe, polake, dhe angleze, të gjitha tekstet janë të barasvlershme. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

PËR KËSHILLIN

E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË POLONISË

VENDIM

Nr. 218, datë 17.4.2019

**PËR TRANSFERIMIN, NË PRONËSI TË
BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE TIRANË, TË
PASURISË ME NR. 3/20, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 8340**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Transferimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pasurisë me nr. 3/20, me vendndodhje në zonën kadastrale 8340, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për t'u përdorur në fushën e arsimit.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, miratuar me vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të

paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës", të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

31	8340 H.I-12	3/20		Truall Rruga "5 maj"		17509		Bashkia	Bashkia	shtet, vol. 16, fq 205 Projekt per shkolle te re Sheshi 8/I, NjA nr.8 Miratuar me VKT nr. 3/19,dt 9.2.2017



VENDIM
Nr. 219, datë 17.4.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 827, DATË 11.12.2003,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MËNYRËN E KODIMIT DHE
STRUKTURËN E NUMRIT TË
IDENTITETIT TË SHTETASVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8951, datë 10.10.2002, “Për numrin personal të shtetasve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 827, datë 11.12.2003, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për mënyrën e kodimit dhe strukturën e numrit personal të shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi”.

2. Kudo në vendim, fjalët “... numri i identitetit ...” zëvendësohen me “... numri personal ...” dhe termi “NISH” zëvendësohet me “NUP”.

3. Në pikën 1, pas fjalës “... shtetasve ...” shtohen fjalët “... shqiptarë, të huaj dhe personat pa shtetësi ...”.

4. Pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

5. Në shkronjën “B”, të aneksit 1, pas tabelës 2 shtohen shkronja “B/1” dhe tabela 2.1, si më poshtë vijon:

“B/1. Për shtetasit e huaj, rezidentë në Shqipëri, si dhe për personat pa shtetësi, të gjinisë mashkullore, muajve (nga 1–12) i shtohet numri 30, ndërsa për personat e gjinisë femërore, muajit i shtohet numri 80, sipas tabelës më poshtë:

Tabela 2.1

Muaji	Gjinia mashkullore (shtetas të huaj)	Gjinia femërore (shtetas të huaj)
1	31	81
2	32	82
3	33	83
4	34	84
5	35	85
6	36	86
7	37	87
8	38	88
9	39	89
10	40	90
11	41	91
12	42	92

6. Pika 2, e shkronjës “E”, të aneksit, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Numrat e elementeve 2 deri në 9 shumëzohen, respektivisht, me numrat 1 deri në 8. Kështu, numri aktual në elementin 2 shumëzohet me 1, numri aktual në elementin 3 shumëzohet me 2, numri aktual në elementin 9 shumëzohet me 8.”.

7. Për letërnjoftimet elektronike, të lëshuara para vitit 2010, metoda e llogaritjes së karakterit të fundit, për efekt kontrolli të numrit personal, bëhet sipas pikës 2, të shkronjës “E”, të aneksit të vendimit, ndërsa, për letërnjoftimet e lëshuara pas vitit 2010, bëhet sipas pikës 6, të këtij vendimi.



8. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 220, datë 17.4.2019

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË MEMALIAJ, TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 264, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 974, DATË 30.9.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË MEMALIAJ, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “gj”, 5, 8 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Memaliaj, për njësinë administrative përbërëse Memaliaj, të pronës me numër rendor 264, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur për zgjerimin e varrezave publike të qytetit Memaliaj.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, t’i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr. 974, datë 30.9.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Memaliaj, të Qarkut të Gjirokastrës”.

3. Bashkisë Memaliaj i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) dhe Bashkia Memaliaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUJTESHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

(Mbeshtetur ne inventarin e pronave te vecanta te tipit Infrastrukture dhe sherbime publike

Per nje shtese ne listen përfundimtare të transferimit të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore ,miratuar me V.K.M
nr.974 date 30.9.2009

Bashkia: Memaliaj

Fusha e përdorimit të pronës : Sherbime Publike (Varreza

Identifikoi : Beqir Gjergji Specialist i Pronave Topograf
(emiri ,mbiemri, pozicioni zyrtar

Supervizioni : Violeta Kanushi .Pergj Zyres Zhvillimit Urban Kadastres
(emir,mbiemri,pozicioni i punes)

Aprovoi : Durim RROSHI Kryetar i Bashkise)
(emir,mbiemri ,pozicioni zyrtar, tel.firma ,vula)

Nr Rend	Zona Kadaster Indeksi i hartes	A		Lloji i Prones	B		Funksioni për të cilin përdoret pronë	C		
		Nr Pasurise	Nga Sip Totale Sa Ndertese (m2)		Emri i Prones Adresa	Sip Totale e Prones (m2)		Institucioni/Enti Me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti Përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanata)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
264	2646 ME-D-4	2/34	Truall	Truall Bashkia Memaliaj	2726		Sherbim publik per varreza	Bashkia Memaliaj	Bashkia Memaliaj	Kjo pasuri do te përdoret per varrezat publike,



VENDIM

Nr. 221, datë 17.4.2019

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË VLORE, TË PRONËS ME
EMËRTIMIN “BASHKIA” ME
VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 8605**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të shkronjës “a”, të nenit 3, të nenit 5, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, të pronës me emërtimin “Bashkia”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8605, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për realizimin e funksioneve të saj administrative.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

 Bashkia Vlore Fusha e përdorimit të pronës: Administrate				Identifikoi <u>Klaudio MEHMETAJ (Specialist DPKZH)</u> Supervizoi <u>Erjon AMATAJ (Drejtore DPKZH)</u> Aprovoi <u>Dritan LELI (KRYETAR I BASHKISË)</u>							
Nr. Rend.	A			B			C				
	Zona Kadastrale dhe Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës Truall (m2)	Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime të vecanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1	8605 VL-G-13	40/53 40/77	Truall Ndertese	Ambjentet e Bashkisë	1768	951.5	Bashkia	Bashkia	Bashkia	Objekti është me katër kate mbi tokë dhe me një kat nëntokë	



VENDIM

Nr. 222, datë 17.4.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 1086, DATË 28.10.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË LIBRAZHD, TË QARKUT TË
ELBASANIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1086, datë 28.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) të dhënat e pronës me numër rendor 404 zëvendësohen me të dhënat e përcaktuara në formularin që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) prona me numër rendor 404 transferohet në pronësi të Bashkisë Librazhd dhe i shtohet lidhjes 1, në fushën e strehimit e të mbrojtjes civile, për t’u kthyer në fond banese.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Librazhd dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE
(Per inventarin e pronave te vecanta)**

Institucioni i Pushtetit Vendor

Bashkia : LIBRAZHD

Fusha e perdorimit te Prones : Strehim

Identifikoi

Veli Dashi (Specialist)

Supervizoi

Mirela Biba (Specialist)

Aprovoi

Kastriot GURRA Kryetar i Bashkise Librazhd

Nr.	A			B			Funksioni per te cilen perdoret Prona	Institucioni Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni Enti perd. Statusi juridik perdorimit	Te dhena tjera (Shenime vecanta)
	Zona Kadastrale & Indeksi I hartes	Nr. pasurise	Lloji i pasurise	Emri I Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga sip. sa ndertesa (m2)				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2446	1/112	Truall + Ndertese	"Ish Hoteli punetoreve te Hekurudhes"	202	202	Banese	Bashkia Librazhd	Ne perdorim nga 6 familje perfituese nga vendimi date 6.6.1993 nga Rajoni Hekurudhor Prenjas	Godina eshte 2 kat , adoptuar si banese me investimet e vete familjareve

**VENDIM**

Nr. 223, datë 17.4.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
SË FINANCIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(MARRËSI), DHE KfW FRANKFURT AM
MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E
REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS SIPAS
PARIMIT TË EFICIENCËS SË
ENERGJISË, FAZA III**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 22, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza III, me një grant në shumën 2 927 765.96 (dy milionë e nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) euro, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

MARRËVESHJE FINANCIMI

NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM
MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË (“MARRËSI”) 2,927,765.96
EURO

**Programi i rehabilitimit të konvikteve të
Universitetit të Tiranës sipas parimit të
eficiencës së energjisë, Shqipëri – faza III
BMZ-nr. 2017 68 688**

Bazuar në marrëveshjen që do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin Financiar 2017 për projektin “Programi për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve të Universitetit të Tiranës – faza III” (“Marrëveshje qeveritare”), Marrësi dhe KfW-ja bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 1**Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar**

1.1 KfW-ja do të sigurojë një kontribut financiar për Marrësin në një vlerë që nuk kalon shumën 2,927,765.96 EURO.

Ky kontribut financiar nuk do të shlyhet, me përjashtim të rasteve kur kjo parashikohet ndryshe sipas nenit 3.2.

1.2 Marrësi, i cili në këtë rast përfaqësohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Ministria Zbatuese e Programit” ose “MZIP-ja”) do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve të Universitetit të Tiranës, faza III (“Programi”) dhe për të financuar kostot e kursit të këmbimit valutor. MZIP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e Programit, si edhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë për të cilën do të merret miratimi i Marrësit të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“Marrëveshja e veçantë”).

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që do të mbulohen nga Marrësi dhe tatimet doganore



për importet nuk duhet të financohen nga kontributi financiar.

Neni 2 Disbursimi

2.1 KfW-ja do të disbursojë kontributin financiar në përputhje me progresin e Programit dhe bazuar në kërkesën e Marrësit, i cili në këtë rast përfaqësohet nga MZP-ja. Nëpërmjet një marrëveshje të veçantë që do të miratohet nga Marrësi, MZP-ja dhe KfW-ja, do të përcaktojnë procedurat e disbursimit, në veçanti, faktet që provojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.

2.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë disbursimin e fondeve pas datës 30 dhjetor 2021 ose ndonjë datë tjetër për të cilën është rënë dakord ndërmjet dy palëve.

Neni 3 Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, me përjashtim të rasteve, kur:

a) Marrësi nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat brenda afatit;

b) janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që lidhen me këtë Marrëveshje;

c) Marrësi, nëpërmjet MZP-së, nuk mund të provojë se të gjitha shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e caktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi; ose

e) krijohen rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

3.2 Nëse ka ndodhur ndonjë nga situatat e përcaktuara në nenin 3.1 b), c) ose d) dhe nuk janë eliminuar brenda një afati kohor të caktuar nga KfW-ja, afat i cili në asnjë rast nuk mund të kalojë 30 ditë, KfW-ja:

a) mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara në rastin e parashikuar në nenin 3.1 b);

b) në rastin e parashikuar në nenin 3.1 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të

ndonjë shume për të cilën Marrësi nuk është i aftë të provojë se është përdorur sipas qëllimit të përcaktuar;

c) në rastin e parashikuar në nenin 3.1 d), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave, pagesa e të cilave për Marrësin ose në emër të Marrësi përbën shkelje të kuadrit ligjor të zbatueshëm.

Neni 4 Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi duhet të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë dhe që lidhen me nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që lidhen me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 5 Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe çdo person i emëruar prej tij ose saj tek KfW-ja dhe të autorizuar nga modeli i firmës i vërtetuar prej tij ose saj, duhet të përfaqësojnë Marrësin gjatë zbatimit të Marrëveshjes. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe çdo person i emëruar prej tij ose saj do të përfaqësojnë Marrësin gjatë zbatimit të Programit. Kompetencat e përfaqësimit nuk do të përfundojnë deri në momentin që revokimi i tyre i shprehur nga përfaqësuesi i Marrësit i autorizuar në atë kohë, të jetë marrë nga KfW-ja.

5.2 Shtesat ose amendimet e kësaj Marrëveshje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e palëve kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen më shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendim, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendimet e kësaj Marrëveshjeje që ndikojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (Neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim ose deklaratë që është marrë ose dërguar në adresat e mëposhtme të palëve përkatëse kontraktuese ose në ndonjë adresë tjetër të palës



përkatëse kontraktuese që i njoftohet paraprakisht palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Faks: +49 69 7431-2944

Për Marrësin: Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë
Faks: +355 42 228494

Neni 6 Programi

6.1 Marrësi, në këtë rast i përfaqësuar nga MZP-ja,

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe ruajë përputhshmërinë e Programit me praktikën më të mira financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje me plan-projektin e Programit që është rënë dakord ndërmjet MZP-së dhe KfW-së;

b) do të caktojë inxhinierë këshillues të kualifikuar dhe të pavarur për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, si dhe një firmë të kualifikuar për zbatimin e Programit;

c) do të lidhë kontrata për mallrat dhe shërbimet e financuara nga kontributi financiar pasi të jenë kryer procedurat konkurruese ndërkombëtare të ofertimit;

d) do të garantojë financimin e plotë të Programit dhe me kërkesën e KfW-së, do t'i dërgojë KfW-së të dhëna që provojnë se janë mbuluar kostot që nuk janë paguar nëpërmjet kontributit financiar;

e) do të ruajë ose do të marrë masa për ruajtjen e librave dhe dokumenteve që tregojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për Programin, duke treguar qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

f) do u krijojë mundësi përfaqësuesve të KfW-së që në çdo kohë të inspektojnë këto libra dhe dokumente dhe të gjitha dokumentet e tjera që lidhen me zbatimin dhe operimin e Programit,

si dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet e lidhura më të;

g) me kërkesë të KfW-së, do të dërgojë pranë KfW-së, duke i dërguar një kopje edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të gjithë informacionin dhe raportet mbi Programin dhe progresin e tij, dhe

h) me nismën e vet, do të informojë në kohë KfW-në për të gjitha situatat që parandalojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

6.2 MZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet që lidhen me nenin 6.1 në Marrëveshjen e veçantë, e cila do të miratohet nga Marrësi i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

6.3 Për transportin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga kontributi financiar do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes qeveritare, të cilat janë të njohura për Marrësin.

Neni 7 Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Programin

7.1 Për të përmbushur parimet e pranura ndërkombëtare për transparencë maksimale dhe eficiencë në zhvillim dhe bashkëpunim, KfW-ja publikon informacion të zgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Programin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa marrëveshja(et) e lidhur/a me Programin është/janë zbatuar dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “e gjithë perioda”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për zonën e tij të biznesit “KfW Development Bank” (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (si nga KfW-ja ose palët e treta në përputhje me nenin 7.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën sesi ai është financuar, nuk do të përfshijë dokumentacion kontraktues ose informacion sensitiv financiar ose të detajuar në lidhje me biznesin për palët e përfshira në Program ose financimin e tij, të tilla si

a) informacion për të dhënat e brendshme;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;



d) të dhëna personale të personave fizikë;

e) klasifikimi i brendshëm i KfW-së mbi pozicionin financiar të palëve.

7.2 KfW-ja shpërndan informacion të zgjedhur për Programin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë të Gjithë Periudhës me subjektet e përcaktuara më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe eficiencë:

a) Filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe institucionet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë dhe filialet;

c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh Gjerman për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) Organizata ndërkombëtare të përfshira në grumbullimin e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Bashkëpunimin për Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj.

7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë ka kërkuar nga KfW-ja të ndajë me të informacion të zgjedhur për Programin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë të gjithë periudhës me subjektet në vijim, të cilat publikojnë seksionet përkatëse sipas qëllimit:

a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllime të Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Germany Trade & Invest (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/tra.de.FOO>);

c) OECD-ja për qëllime të raportimit të flukseve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllime të vlerësimit të të gjithë bashkëpunimit gjerman në kuadër të zhvillimit për të siguruar transparencë dhe eficiencë (<http://www.deval.org/de/>).

7.4 Më tej, KfW-ja ruan të drejtën të transferojë tek palët e treta, për sa kohë që janë ruajtur interesat legjitime, (dhe për qëllime publikimi) informacion për Programin dhe

mënyrën sesi është financuar gjatë të gjithë periudhës.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat legjitime të Marrësit mbi informacionin që nuk do të transferohet nuk balançojnë interesat e KfW-së, nëse ai transferohet. Interesa legjitime të Marrësit përfshijnë konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përcaktuar në nenin 7.1, i cili është i përjashtuar nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacionin tek palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave rregullatore ose statutore ose për të pohuar ose mbrojtur paditë ose të drejta të tjetra ligjore para gjykatës ose procedura administrative.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi, nëpërmjet MZP-së, do të garantojë që personat e ngarkuar prej tyre për përgatitjen dhe zbatimin e Programit, lidhjen e kontratës për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen dhe që kërkojnë disbursimin e shumave të kontributit financiar nuk do të kërkojnë, pretendojnë, pranojnë, premtojnë ose marrin një premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera që lidhen me detyrat që kanë.

8.2 Marrësi, nëpërmjet MZP-së, nuk do të kryejë transaksione ose nuk do të angazhohet në aktivitete të tjera që lidhen me Programin, të cilat do të përbënin shkelje të embargoeve që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare ose të ashtuquajturat sanksione financiare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian ose Republikës Federale të Gjermanisë.

8.3 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që do të shkaktohej nga kjo, do të plotësohet nga dispozita që janë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.4 Marrësi nuk duhet të caktojë ose transferojë, lërë peng ose si garanci ndonjë të drejtë të lindur nga kjo Marrëveshjeje.

8.5 Për këtë Marrëveshjeje do të zbatohet ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i ekzekutimit do të jetë Frankfurt am Main.



8.6 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë në fund të periudhës së Programit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

8.7 Kjo Marrëveshje financiare do të hyjë në fuqi sapo të jenë përmbushur kushtet në vijim:

i) KfW-ja ka marrë njoftimin me shkrim nga Marrësi se procedurat e brendshme ligjore për tu përmbushur nga Marrësi kanë përfunduar; dhe ii) Marrëveshja qeveritare ka hyrë në fuqi dhe është efektive.

Bërë në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
në datën 18 dhjetor
2018
KfW

Tiranë
në datën 18 dhjetor
2018
Republika e Shqipërisë,
e përfaqësuar nga
Ministria e Financave
dhe Ekonomisë

VENDIM
Nr. 224 datë 17.4.2019

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDIT PËR ZHVILLIM ABU DHABI,
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“NDËRTIMI I BULEVARDIT VERIOR
DHE REHABILITIMI I LUMIT TË
TIRANËS”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 150/2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit “Ndërtimi i bulevardit verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës”, të ratifikuar me ligjin nr.150/2013, me

qëllim shtyrjen e afatit të disbursimit, sipas marrëveshjes së huas, deri më 30.6.2020, sipas përmbajtjes së dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

FONDI PËR ZHVILLIM I ABU DHABIT

Datë: 28.11.2018
Ref: ADFD-DG-1768-2018

Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3,
Tiranë

Lënda: Projekti i rehabilitimit të lumit të Tiranës – “Moskundërshtimi” për zgjatjen e datës së fundit për tërheqje (LDW)

Shkëlqesia juaj,
Fondi për Zhvillim i Abu Dhabi (FZHADH) iu shpreh përshëndetjet më të ngrohta.

Më tej, kjo letër vjen në vijim të shkresës suaj me numër reference 19/4, të datës 17 korrik 2018 në lidhje me kërkesën tuaj për zgjatjen e datës së fundit për Tërheqjet (LDW) për Projektin e Lumit të Tiranës.

Do të donim t’iu informonim se FZHADH-ja nuk ka asnjë kundërshtim për zgjatjen e datës së fundit për tërheqjet (LDW) për Projektin e lumit të Tiranës deri më 30 qershor 2020.

Ju lutem pranoni përshëndetjet dhe konsideratat tona më të ngrohta.

Me respekt,

Nënshkrimi

Mohammed Saif Al Suwaidi
Drejtore i përgjithshëm

**VENDIM**

Nr. 225, datë 17.4.2019

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE
NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
QEVERINË E REPUBLIKËS SË
FRANCËS, PËR RINDËRTIMIN
E KATEDRALES “NOTRE-DAME”
NË PARIS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për qeverinë e Republikës së Francës, në masën 100 000 (njëqind mijë) euro, për rindërtimin e Katedrales “Notre-Dame” në Paris, pas dëmeve të shkaktuara nga zjarri.

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, në zërin “Shpenzime korrente”, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 100 000 (njëqind mijë) eurosh, për qëllimin sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 226, datë 17.4.2019

**PËR KATEGORITË E SHËRBIMEVE TË
OFRUARA NGA ENTET SHTETËRORE
DHE SUBJEKTE TË TJERA, TË CILAT
PËRFITOHEN ME ÇMIME TË
REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT
TË KARTËS SË STUDENTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 100, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimet që ofrohen nga entet shtetërore në fushën e artit dhe të kulturës, të shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, si një dokument unik i çdo studenti.

2. Ministrat, sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse, miratojnë, me urdhër të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për arsimin, listën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara për studentët. Në urdhrin e përbashkët përcaktohen çmimet e reduktuara për shërbimet që do të ofrohen. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i secilës ministri, ofruese e shërbimit për studentët, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

3. Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara edhe nga subjekte të tjera publike apo private, që kanë objekt të fushës së veprimtarisë së tyre shërbime për studentët, në bazë të marrëveshjeve përkatëse, pa efekte financiare për buxhetin e shtetit, të nënshkruara me ministrinë përgjegjëse për arsimin.

4. Në nivel vendor, marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit nënshkruhen ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet



financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

5. Njësitet e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë marrëveshje me subjekte të tjera publike dhe private për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.

6. Çdo institucion i arsimit të lartë mund të nënshkruajë marrëveshje, pa efekte financiare, me subjekte publike apo private, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme, në nivel qendror apo vendor, me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.

7. Marrëveshjet e lidhura nga njësitet e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e arsimit të lartë marrin miratimin paraprak në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Ministria përgjegjëse për arsimin konfirmon miratimin brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga njoftimi i marrëveshjes. Në rast se konfirmimi nuk paraqitet brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, miratimi konsiderohet i dhënë.

8. Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë të gjitha shërbimet e ofruara sipas përcaktimeve të këtij vendimi nëpërmjet paraqitjes së kartës së studentit si dokument unik. Shërbimet e ofruara, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, bëhen publike nga të gjitha institucionet qendrore e vendore, si dhe nga subjektet publike e private në faqet e tyre zyrtare, ndërsa ministria përgjegjëse për arsimin publikon të gjitha shërbimet e siguruara me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.

9. Karta e studentit mund të bëhet pjesë e projekteve ndërkombëtare përmes marrëveshjeve që lidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo pjesëmarrje mundëson që shërbimet e ofruara nga këto projekte të përfitohen nga të gjithë përfituesit e kartës së studentit në shtetet anëtare të projektit apo të marrëveshjeve ndërkombëtare. Efektet financiare të pjesëmarrjes në projektet ndërkombëtare përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

10. Shpenzimet për prodhimin dhe administrimin e kartës së studentit do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i ministrive sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

11. Në rast se njësitet e vetëqeverisjes vendore paraqesin kërkesë për prodhimin dhe

administrimin e kartës së studentit, ministria përgjegjëse për arsimin nënshkruan një marrëveshje dypalëshe me këto njësi për delegimin e këtyre përgjegjësisë e kompetencave. Në këtë rast, shpenzimet do të përballohen nga buxheti i këtyre njësive.

12. Qendra e Shërbimeve Arsimore konfirmon, për çdo vit akademik, studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik, për çdo institucion të arsimit të lartë, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në rastin e delegimit të prodhimit dhe të administrimit të kartës së studentit.

13. Ngarkohen ministrinë sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitet e vetëqeverisjes vendore, entet shtetërore, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 227, datë 17.4.2019

**PËR PËRGATITJEN, SHTYPJEN,
BOTIMIN DHE SHPËRNDARJEN E
TEKSTEVE SHKOLLORE TË ARSIMIT
BAZË PËR NXËNËSIT E
INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PUBLIKE PARAUNIVERSITARE, KU
MËSOJNË NXËNËS TË PAKICAVE
KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Ministria përgjegjëse për arsimin siguron shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare.

2. Lista e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, përcaktohet nga ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me nevojat e evidentuara për çdo vit shkollor.

3. Tekstet shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, të përgatitura e që janë gjendje pranë strukturave shtetërore, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila i riboton këto tekste, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar të drejtat e detyrimit lidhur me këto tekste.

4. Ministria përgjegjëse për arsimin siguron përkthimin e teksteve të katalogut zyrtar të teksteve shkollore, nga gjuha shqipe në gjuhën e pakicës kombëtare, në përputhje me lëndët mësimore që zhvillohen në arsimin bazë, të cilat nuk janë gjendje, sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij vendimi.

5. Për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, për secilën prej gjuhëve amtare të pakicave kombëtare përkthehet vetëm një alternativë nga katalogu zyrtar i teksteve shkollore. Alternativa që do të përkthehet do të jetë teksti shkollor më i përzgjedhur nga mësuesit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare. Teksti i përzgjedhur dhe i përkthyer nuk ndryshon deri në ndryshimin e programit mësimor.

6. Të drejtën për përkthimin, botimin dhe shpërndarjen e tekstit shkollor, sipas pikës 5, të këtij vendimi, e ka shtëpia botuese që gëzon të drejtat për tekstin shkollor.

7. Procedura për përkthimin, botimin dhe shpërndarjen e tekstit shkollor të përcaktuar në pikat 5 e 6, të këtij vendimi, realizohet sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik.

8. Në rastet kur shtëpia botuese nuk mund të realizojë përkthimin, botimin dhe shpërndarjen e tekstit shkollor, sipas pikës 5, të këtij vendimi, të drejtat i kalojnë ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila përkthen, shtyp, boton dhe shpërndan tekstet shkollore, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

9. Për hartimin e teksteve shkollore të reja në gjuhën amtare të pakicave kombëtare, të cilat nuk janë gjendje, sipas përcaktimit të pikave 2 e 3, të këtij vendimi, dhe nuk janë pjesë e katalogut zyrtar të teksteve shkollore, institucioni përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe të standardeve për tekstet mësimore apo sigurimin e cilësisë së arritjeve në arsimin parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për secilin tekst shkollor, formon grupet e autorëve dhe komisionet e posaçme për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e teksteve. Anëtarët e grupeve dhe të komisioneve paguhën sipas akteve nënligjore në fuqi.

10. Tekstet e miratuara nga komisionet e posaçme të ngritura nga institucioni përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe të standardeve për tekstet mësimore apo sigurimin e cilësisë së arritjeve në arsimin parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i paraqiten ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila i boton këto tekste, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar të drejtat e detyrimit lidhur me këto tekste.

11. Kërkesat për pajisjen me tekste shkollore për nxënësit e pakicave kombëtare, që mësojnë në institucionet arsimore publike të arsimit bazë, dërgohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, brenda muajit janar të çdo viti. Përfundimisht, për vitin shkollor 2019–2020, kërkesat paraqiten brenda muajit prill 2019.

12. Kostoja e përgatitjes, shtypjes, botimit dhe shpërndarjes së teksteve shkollore të arsimit bazë, për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, mbulohet nga fondet buxhetore të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucioni përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe të standardeve për tekstet



mësimore apo sigurimin e cilësisë së arritjeve në arsimin parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 229, datë 17.4.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
NJOHJEN E NDËRSJELLË TË
PATENTË SHOFRERËVE/LEJEVE
TË DREJTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e ndërsjellë të patentë shoferëve/lejeve të drejtimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË
PATENTË SHOFRERËVE/LEJEVE TË
DREJTIMIT**

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (më poshtë të referuara “Palë Kontraktuese”);

Me qëllim të përmirësimit të sigurisë në rrugë, si dhe për të lehtësuar qarkullimin rrugor në territoret e të dyja Palëve Kontraktuese;

Kanë rënë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

1) Palët Kontraktuese njohin reciprokisht zëvendësimin/konvertimin e patentë shoferëve/lejeve të drejtimit të vlefshme, të lëshuara nga Autoritetet Kompetente të palës tjetër kontraktuese, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, në favor të mbajtësve të patentë shoferëve/lejeve të drejtimit, të cilët kanë fituar të drejtën e vendqëndrimit të ligjshëm/rezidencën normale në territorin e vendit të tyre.

2) Modelet e patentë shoferëve/lejeve të drejtimit të Palëve Kontraktuese do t'i bashkëngjiten dhe janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje (shtojca 1).

3) Për arsye të qarkullimit të pandërprerë të trafikut të mjeteve në territorin e tyre, Palët Kontraktuese njohin gjithashtu patentë shoferët/lejet e drejtimit, të lëshuara nga Pala tjetër Kontraktuese brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre.

Neni 2

Patentë shoferët/lejet e drejtimit e lëshuara nga Autoritetet Kompetente të njëres nga Palët Kontraktuese do të konsiderohen të pavlefshme për qarkullim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pasi të ketë përfunduar periudha për të drejtën e vendqëndrimit, sikundër është përcaktuar me legjislacionin e brendshëm, të asaj Pale Kontraktuese.



Neni 3

Me qëllim të interpretimit të neneve të kësaj marrëveshje, termi “vendqëndrim”/“rezidencë normale” do të nënkuptojë ashtu sikundër është e përkufizuar dhe rregulluar me legjislacionin e brendshëm të Palëve Kontraktuese.

Neni 4

1) Nëse mbajtësi i patentë shoferit/lejes së drejtimit, të lëshuar nga Autoritetet Kompetente nga Palët Kontraktuese i është dhënë e drejta e vendqëndrimit, në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese, atëherë të dy Palët Kontraktuese në mënyrë reciproke do të zëvendësojnë / konvertojnë patentë shoferët/lejet e drejtimit, pa pasur nevojë për provime plotësuese teorike apo testime praktike të drejtimit të mjetit.

2) Gjatë procedurës së zëvendësimit /konvertimit të patentë shoferëve/lejeve të drejtimit, të lëshuara nga Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese do të kërkohet certifikata mjekësore që dëshmon aftësitë psikofizike të personit në fjalë për të drejtuar mjete të kategorisë së caktuar në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi të shtetit të Palëve Kontraktuese.

3) Me qëllim të zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, mbajtësit e patentë shoferëve/lejeve të drejtimit, duhet ta kenë moshën sikurse përcaktohet në legjislacionin e brendshëm përkatës të Palëve Kontraktuese për marrjen e patentë shoferit/lejes së drejtimit për kategorinë për të cilën kërkohet të kryhet zëvendësimi/konvertimi.

Neni 5

Dispozitat e përcaktuara në nenin 4 të kësaj marrëveshje nuk do të vlejné për patentë shoferët/lejet e drejtimit, të lëshuara nga një vend i tretë, për të cilat është kryer zëvendësimi/konvertimi në territorin e njëres nga Palët Kontraktuese, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palëve në fjalë.

Neni 6

1) Gjatë zëvendësimit/konvertimit të patentë shoferëve/lejeve të drejtimit, kategoritë e

barasvlershme në patentë shoferët/lejet e drejtimit të Palëve Kontraktuese do të njihen në bazë të tabelës së barasvlershmërisë, e cila do të jetë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje (Shtojca 2).

2) Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese për zbatimin e kësaj marrëveshje do të jenë:

-për Republikën e Shqipërisë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë — Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

-për Republikën e Kosovës: Ministria e Punëve të Brendshme — Drejtorati për Pajisje me Dokumente, Sektori për Patentë Shoferë;

3) Në zbatimin e kësaj marrëveshje Palët Kontraktuese do të përdorin gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Neni 7

Gjatë procedurës së zëvendësimit / konvertimit të patentë shoferëve/lejeve të drejtimit, Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese tërheqin patentë shoferin/lejen e drejtimit origjinale dhe ua kthejnë Autoriteteve Kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, së bashku me një listë të këtyre patentë shoferëve/lejeve të drejtimit dhe njoftimin për këtë qëllim.

Neni 8

1) Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese mund të kërkojnë përkthim zyrtar, lidhur me vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për njohjen e një patentë shoferi/lejes së drejtimit.

2) Para se të ndodhë zëvendësimi/konvertimi, Autoriteti Kompetent i njëres nga Palët Kontraktuese do të kërkojë informacion nga Autoriteti Kompetent i Palës tjetër Kontraktuese për të konfirmuar vlefshmërinë dhe vërtetësinë për të dhënat e patentë shoferit/lejes së drejtimit që do të zëvendësohet/konvertohet.

3) Shkëmbimi i të dhënave do të realizohet nëpërmjet postës elektronike, duke shfrytëzuar format e “Kërkesës për Vërtetimin e Vlefshmërisë së patentë shoferit/lejes së drejtimit” dhe “Certifikatën për Vlefshmërinë e patentë shoferit/lejes së drejtimit”, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje (shtojca 3 dhe shtojca 4).



4) Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese do të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim, lidhur me çfarëdo ndryshimi të kërkesës dhe certifikatës për vlefshmërinë, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

5) Të dhënat do të dërgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet postës elektronike, tek Autoriteti Kompetent sipas kërkesës së Palës Kontraktuese.

Neni 9

Autoriteti Kompetent i një Pale Kontraktuese që merr patentë shoferin/lejen e drejtimit të tërhequr pas zëvendësimit/konvertimit, njofton Autoritetin Kompetent të Palës tjetër Kontraktuese lidhur me parregullsitë e mundshme të patentë shoferit/lejes së drejtimit për sa i përket vlefshmërisë dhe vërtetësisë dhe të dhënat që përmban.

Neni 10

Trajtimi i të dhënave personale do të bëhet në pajtim me legjislacionin përkatës të Palëve Kontraktuese.

Neni 11

1) Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e pranimi të njoftimit të fundit me shkrim përmes kanaleve diplomatike, që vërtetojnë se Palët Kontraktuese kanë përmbushur të gjitha

procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

2) Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqim të dyanshëm me shkrim të të dyja Palëve Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike. Ndryshimet duhet të hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3) Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultime dhe negociata ndërmjet të dy Palëve Kontraktuese.

4) Cilado nga Palët Kontraktuese mund të shfuqizojë këtë marrëveshje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim dërguar Palës tjetër Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, shfuqizimi hyn në fuqi gjashtë muaj nga data e pranimi të këtij njoftimi.

5) Kjo marrëveshje do të ketë kohëzgjatje të pacaktuar.

Bërë në Pejë, më 26.11.2018, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze ku i gjithë teksti është njëloj autentik. Në rast të ndonjë dallimi në interpretim, do të mbizotërojnë teksti në gjuhën angleze i marrëveshjes.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS



SHTOJCA 1


MODELET E PATENTË SHOFERIT TË LËSHUARA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

I. Modeli i patentë shoferit të Republikës së Kosovës në përdorim zyrtar prej datës 13.11.2008

A) Ana e përparme



B) Ana e prapme






II. Modeli i patentë shoferit të Republikës së Kosovës në përdorim zyrtar sipas Ligjit Nr.05/L-064 “Për patentë shoferi” (gazeta/fletorja zyrtare nr. 17, datë 10 qershor 2016).

A) Ana e përparme




B) Ana e prapme




MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT TË LËSHUARA NË SHQIPËRI

I. Modeli i lejes së drejtimit, lëshuar nga data 01.07.2005 deri më 24.01.2017

A) Ana e përparme



B) Ana e prapme






II. Modeli i lejes së drejtimit, lëshuar nga data 24.01.2017 e në vijim

A) Ana e përparme



B) Ana e prapme





SHTOJCA 2

TABELAT E BARASVLERËSIMIT

1. Për zëvendësimin/ konvertimin e patentë shoferëve të lëshuar në Republikën e Kosovës nga data 13.11.2008, në leje drejtimi të Republikës së Shqipërisë.


Patentë shoferi e Republikës së Kosovës	Leje drejtimi e Republikës së Shqipërisë														
	AM	A1	A2	A	B1	B	C1	C	D1	D	BE	C1E	CE	D1E	DE
A1		✓													
A*		✓													
A				✓											
B1					✓										
B						✓									
C1							✓								
C								✓							
D1									✓						
D										✓					
BE											✓				
C1E												✓			
CE													✓		
D1E														✓	
DE															✓
M															
L															
T															

Kategoria A* - 25 KW Fuqia motorike e motoçikletës me raport fuqi/ peshë 0,16KW / KG

Shënim: Kategoritë e larta të lejeve të drejtimit përfaqësojnë edhe kategoritë më të ulta, p.sh. kat. B përfaqëson edhe kategoritë AM, A1, A2, A dhe B1.

2. Për zëvendësimin/ konvertimin e patentë shoferëve të lëshuar në Republikën e Kosovës, sipas **Ligjit Nr.05/L-064 “Për Patentë shoferi” (gazeta zyrtare/fletore zyrtare Nr.17, datë 10 qershor 2016)** në leje drejtimi të Republikës së Shqipërisë.

Patentë shoferi e Republikës së Kosovës	Leje drejtimi e Republikës së Shqipërisë														
	AM	A1	A2	A	B1	B	C1	C	D1	D	BE	C1E	CE	D1E	DE
AM	✓														
A1		✓													
A2			✓												
A				✓											
B1					✓										
B						✓									
C1							✓								
C								✓							
D1									✓						
D										✓					
BE											✓				
C1E												✓			
CE													✓		
D1E														✓	
DE															✓
M															





SHTOJCA 3

Nga

Republika e Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme
Drejtoria për Pajisje me Dokumente
Sektori për Patentë Shoferë
Fax: +381 (0) 38211748
e-mail: dpd.patentshofer@rks-gov.net

Për

Republika e Shqipërisë
Ministria e Infrastrukturës dhe
Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor
Fax: 00355 4 2238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al

**KËRKESË
PËR VËRTETIMIN E VLEFSHMËRISË SË LEJE DREJTIMIT**

Lutemi na informoni nëse leja e drejtimit Nr. është e vlefshme dhe nëse përmban detajet në vijim:

- Emri:
- Mbiemri:
- Data e lindjes:
- Vendi i lindjes:
- Data e lëshimit:
- Data e skadimit:
- Kategoritë:

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur kopjen lejes së drejtimit.

Vendi dhe data

Vula dhe Nënshkrimi i Zyrtarit

Nga

Republika e Shqipërisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të
Transportit Rrugor
Fax: 00355 4 2238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al

Për

Republika e Kosovës
Ministria e Punëve të
Brendshme
Drejtoria për Pajisje me
Dokumente
Sektori për Patentë Shoferë
Fax: +381 (0) 38211748
E-mail: dpd.patentshofer@rks-gov.net

**KËRKESË
PËR VËRTETIMIN E VLEFSHMËRISË SË PATENTË SHOFERIT**

Lutemi na informoni nëse patentë shoferi Nr. është e vlefshme dhe nëse përmban detajet në vijim:

- Emri:
- Mbiemri:
- Data e lindjes:
- Vendi i lindjes:
- Data e lëshimit:
- Data e skadimit:
- Kategoritë:

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur kopjen e patentë shoferit.

Vendi dhe data

Vula dhe Nënshkrimi i Zyrtarit



SHTOJCA 4

Nga

Republika e Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme
Drejtoria për Pajisje me Dokumente
Sektori për Patentë Shoferë
Fax: +381 (0) 38211748
e-mail: dpd.patentshofer@rks-gov.net

Për

Republika e Shqipërisë
Ministria e Infrastrukturës dhe
Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor
Fax: 00355 4 2238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al

CERTIFIKATA PËR VLEFSHMËRINË E PATENTË SHOFERIT

Ju informojmë se patentë shoferi Nr. është i vlefshëm dhe përmban
detajet në vijim:

A. Të dhëna për mbajtësin e patentë shoferit:

- Emri:
- Mbiemri:
- Data e lindjes:
- Vendi i lindjes:

B. Përshkrime të veçanta (syze, protezë akustike, etj.):**C. Patentë shoferi është i vlefshëm deri më: ____/____/____****D. Data e kualifikimit të parë:**

- Kategoria “ ” ____/____/____
- Kategoria “ ” ____/____/____
- Kategoria “ ” ____/____/____

**E. Patentë shoferi vjen*/ nuk vjen* nga zëvendësime/ konvertime të tjera të
huaja të lëshuar nga:**

Data dhe vendi

Vula dhe Nënshkrimi i Zyrtarit

(*) Shënoni rastin kur ai përsëritet

Nga

Republika e Shqipërisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të
Transportit Rrugor
Fax: 00355 4 2238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al

Për

Republika e Kosovës
Ministria e Punëve të
Brendshme
Drejtoria për Pajisje me
Dokumente
Sektori për Patentë Shoferë
Fax: +381 (0) 38211748
E-mail: dpd.patentshofer@rks-gov.net

CERTIFIKATA PËR VLEFSHMËRINË E LEJES SË DREJTIMIT

Ju informojmë se leja e drejtimit Nr. është e vlefshme dhe përmban detajet në vijim:

A. Të dhëna për mbajtësin e lejes së drejtimit:

- Emri:
- Mbiemri:
- Data e lindjes:
- Vendi i lindjes:

B. Përshkrime të veçanta (syze, protezë akustike, etj.):

.....

C. Leja e drejtimiti është e vlefshme deri më: ____/____/____**D. Data e kualifikimit të parë:**

- Kategoria “ ____ ” ____/____/____
- Kategoria “ ____ ” ____/____/____
- Kategoria “ ____ ” ____/____/____

E. Leja e drejtimit vjen*/ nuk vjen* nga zëvendësime/ konvertime të tjera të huaja të lëshuar nga:

Data dhe vendi

(*) Shënoni rastin kur ai përsëritet

Vula dhe Nënshkrimi i Zyrtarit

**VENDIM****Nr. 233, datë 17.4.2019****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLIMEVE
TË VEÇANTA LIDHUR ME
FUNKSIONIMIN E MJEDISEVE, TË
NIVELIT TË SIGURISË SË TYRE DHE
STANDARDET E PROGRAMEVE TË
EDUKIMIT E TË REHABILITIMIT,
NË RASTET E KUFIZIMIT TË LIRISË
SË TË MITURVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 98, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

1. Kufizimi i lirisë për të miturin në konflikt me ligjin zbatohet vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur dhe në mënyrë që nuk e përkeqëson gjendjen e tij.

2. Të miturit me liri të kufizuar i garantohen aktivitete dhe programe me karakter edukues dhe riintegruues, në përputhje me shëndetin e tij fizik e mendor, respektin për veten dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj shoqërisë e komunitetit.

3. I mituri me liri të kufizuar duhet të mbështetet e nxitet për të marrë pjesë në këto aktivitete e programe dhe për të diskutuar çështje që lidhen me mënyrën e trajtimit dhe kushtet e institucionit.

4. Për të garantuar vazhdimësinë e kujdesit, të miturit duhet të ndiqen e mbështeten, me qëllim rehabilitimin e tyre.

5. Duke qenë se të miturit e privuar nga liria janë veçanërisht vulnerabël, drejtuesit dhe personeli i institucionit duhet të mbrojnë integritetin e tyre fizik e mendor dhe duhet të kujdesen për mirëqenien e tyre.

6. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për nevojat e të miturve që kanë përjetuar abuzime fizike, mendore apo seksuale.

II. RREGULLA PËR FUNKSIONIMIN E MJEDISEVE**1. Struktura institucionale**

1.1 Institucioni i kufizimit të lirisë duhet të ofrojë lehtësitë dhe kushtet për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturve që vendosen në të.

1.2 Institucioni i kufizimit të lirisë siguron kushte dhe masa të një niveli të ulët sigurie e kontrolli të nevojshëm për mbrojtjen e të miturve nga dëmtime që mund t'i bëjnë vetes, të miturve të tjerë, personelit apo komunitetit jashtë institucionit.

1.3 Jetesa në institucion duhet të përafrojë, sa më shumë të jetë e mundur, me aspektet pozitive të jetesës në komunitet.

1.4 Numri i të miturve në një institucion të kufizimit të lirisë duhet të jetë i kufizuar, me qëllim që të bëhet i mundur kujdesi individual.

1.5 Institucioni i kufizimit të lirisë vendoset në vende që janë lehtësisht të aksesueshme dhe që lehtësojnë kontaktin ndërmjet të miturve dhe familjeve të tyre, duke u integruar në mjedisin social, ekonomik e kulturor të komunitetit.

2. Vendosja në institucion

2.1 Vendosja e kategorive të ndryshme të të miturve në institucionin e kufizimit të lirisë udhëhiqet, në veçanti, nga dhënia e llojit të kujdesit më të përshtatshëm për nevojat e tyre të veçanta si dhe mbrojtja e integritetit e mirëqenies së tyre fizike e mendore.

2.2 Të miturit vajza dhe djem, zakonisht, mbahen në institucione të veçanta ose në njësi të veçanta brenda një institucioni. Pavarësisht ndarjes, atyre u lejohet të marrin pjesë bashkërisht në aktivitetet e organizuara në institucion.

2.3 Brenda institucioneve duhet të funksionojë një sistem i përshtatshëm vlerësimi për vendosjen e të miturve, sipas nevojave të tyre arsimore, zhvillimore dhe të sigurisë.

3. Pranimi në institucion

3.1 Menjëherë, me pranimin në institucionin e kufizimit të lirisë, kryhet regjistrimi për çdo të mitur, duke përfshirë:

a) informacion lidhur me identitetin e të miturit dhe prindërit e tij ose kujdestarët ligjorë;

b) arsyet e urdhrit zyrtar dhe autoritetin përgjegjës, që e ka dhënë;

c) datën dhe kohën e pranimi;

ç) një inventar të sendeve personale të të miturit, që do të mbahen në ruajtje;



d) çdo dëmtim të dukshëm apo pretendim për keqtrajtim të mëparshëm;

dh) çdo informacion dhe çdo raport mbi të kaluarën e të miturit, edukimin dhe nevojat për mirëqenie të tij/saj;

e) çdo informacion në lidhje me rrezikun për vetëdëmtim të të miturit dhe/ose të gjendjes shëndetësore, që është i rëndësishëm për mirëqenien fizike e mendore të të miturit ose të të tjerëve, duke iu nënshtruar kërkesave të konfidencialitetit mjekësor.

3.2 Në pranim, rregullat e institucionit dhe të drejtat e detyrimit e të miturit shpjegohen në një gjuhë e mënyrë që i mituri i kupton dhe në prani edhe të psikologut.

3.3 Njoftimi për vendosjen e të miturit, informacioni për rregullat e institucionit dhe çdo informacion tjetër përkatës u jepen menjëherë prindërve të të miturit ose kujdestarëve ligjorë.

3.4 Brenda 5 (pesë) ditëve, nga pranimi, i mituri duhet të ekzaminohet nga pikëpamja mjekësore, t'i hapet një dosje mjekësore dhe të fillojë trajtimin e çdo sëmundjeje ose dëmtimi.

3.5 Brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga pranimi, i mituri duhet të:

a) intervistohet dhe duhet të bëhet një raport i parë psikologjik, arsimor e social, që identifikon çdo faktor relevant për llojin dhe nivelin specifik të kujdesit e ndërhyrjes;

b) informohet për planin e programeve arsimore e trajnuese, në përputhje me karakteristikat individuale të tij. Në çdo rast, për zhvillimin e programeve duhet të merret mendimi i të miturit.

4. Sistemimi në institucion

4.1 Sistemimi i miturit në institucionin e kufizimit të lirisë duhet të respektojë dinjitetin njerëzor e, për aq sa është e mundur, privatësinë, dhe të plotësojë kërkesat e shëndetit dhe të higjienës, duke i kushtuar vëmendje kushteve klimatike dhe, veçanërisht, hapësirës së katit, ajrit, ndriçimit, ngrohjes e ventilimit.

4.2 Të miturit, si rregull, vendosen gjatë natës në dhoma gjumi individuale, përveç rasteve kur është e preferueshme që ata të ndajnë hapësirën e fjetjes. Hapësira ndahet vetëm nëse është e përshtatshme dhe kërkohet nga i mituri.

4.3 Për të siguruar mbrojtjen e secilit të mitur, në institucionin e kufizimit të lirisë duhet të ketë mbikëqyrje të rregullt. Institucioni i kufizimit të

lirisë duhet të ketë një sistem alarmi efektiv, që mund të përdoret në rast emergjence.

4.4 Kërkesat minimale, specifike, në lidhje me sistemimin e të miturit në institucionin e kufizimit të lirisë, përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit.

5. Higjiena

5.1 Të gjitha ambientet e institucionit të kufizimit të lirisë mbahen të pastra, në çdo kohë.

5.2 Të miturit duhet të kenë akses të menjëhershëm në objektet sanitare, që janë higjienike dhe që respektojnë jetën private.

5.3 Duhet të sigurohen lehtësira të përshtatshme, në mënyrë që të miturit të kenë mundësi të bëjnë dush çdo ditë.

5.4 Personeli i institucionit të kufizimit të lirisë kujdeset për sigurimin e higjienës personale të të miturit, veshjet dhe vendin e fjetjes, si dhe siguron mjetet e nevojshme për këtë qëllim.

6. Veshjet dhe shtroja

6.1 Të miturit duhet të lejohen të veshin rrobat e tyre, nëse është e përshtatshme.

6.2 Të miturit, të cilët nuk kanë veshje të përshtatshme e të mjaftueshme, duhet të pajisen me veshje nga institucioni.

6.3 Veshjet nuk duhet të jenë degraduese ose poshtëruese, duhet të jenë të përshtatshme për klimën dhe të mos paraqesin rrezik për sigurinë e mirëqenien.

6.4 Të miturit, që ka leje për të dalë jashtë institucionit, nuk duhet t'i kërkohet të mbajë rroba që e identifikojnë atë si person me liri të kufizuar.

6.5 I mituri pajiset me një shtrat dhe me shtroja të përshtatshme, të cilat mbahen në rregullta dhe ndryshohen shpesh, për të siguruar pastërtinë e tyre.

7. Ushqimi

7.1 Të miturit i sigurohet një dietë ushqyese që merr parasysh moshën, shëndetin, gjendjen fizike, fenë, kulturën dhe aktivitetet, në të cilat përfshihet në institucion.

7.2 Ushqimi duhet të përgatitet e të shërbehet në mënyrë higjienike, në tri vakte në ditë, me intervale të arsyeshme ndërmjet tyre.

7.3 Ujë i pijshëm e i pastër duhet të jetë i disponueshëm për të miturin në çdo kohë.

8. Shëndeti



8.1 Të miturit me liri të kufizuar i sigurohen standardet e duhura mjekësore dhe të aplikuar për të gjithë të miturit.

8.2 Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajtimit të rreziqeve shëndetësore, të lidhura me kufizimin e lirisë.

8.3 Të miturit me liri të kufizuar i jepet kujdes shëndetësor parandalues dhe edukim shëndetësor.

8.4 Ndërhyrjet mjekësore, përfshirë përdorimin e ilaçeve, duhet të bëhen vetëm me rekomandimin e mjekut të institucionit dhe jo për qëllime të ruajtjes së rendit ose si formë ndëshkimi. Ndërhyrjet mjekësore duhet të udhëhiqen nga të njëjtat parime etike si dhe parimi i pëlqimit, që aplikohen gjerësisht. Çdo trajtim mjekësor ose çdo lloj bari i administruar duhet të dokumentohet me nënshkrimin e mjekut të institucionit.

8.5 I mituri me liri të kufizuar nuk duhet t'i nënshtrohet përdorimit eksperimental të barnave ose trajtimit.

8.6 Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojave të të miturit:

- a) me moshë të vogël;
- b) shtatzënë ose nënë me fëmijë të mitur;
- c) me varësi nga drogat dhe alkooli;
- ç) me probleme të shëndetit fizik e mendor;
- d) me liri të kufizuar për periudhë të gjatë;
- dh) që ka përjetuar abuzime fizike, mendore ose seksuale;
- e) vulnerabël.

8.7 Shërbimet e kujdesit shëndetësor, të ofruara për të miturin, duhet të jenë pjesë përbërëse e një programi shumëdisiplinor përkujdesjeje.

8.8 Për të siguruar një mbështetje të pandërprerë të terapisë, pa paragjykim për konfidencialitetin profesional dhe rolin e secilit profesion, puna e mjekëve dhe infermierëve duhet të koordinohet ngushtë me punonjësit socialë, psikologët, mësuesit, profesionistët e tjerë dhe personelin, të cilët kanë kontakt të rregullt me shkelësit e mitur.

8.9 Kujdesi shëndetësor nuk duhet të kufizohet vetëm në trajtimin e pacientëve të sëmurë, por duhet të përfshijë edhe respektimin e normës së të ushqyerit.

9. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

9.1 Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë së të miturit duhet të respektohet.

9.2 Regjimi institucional duhet të organizohet, për aq sa është e mundur, për të lejuar të miturin të praktikojë e të ndjekë besimin e vet, të marrë pjesë në shërbime ose takime të udhëhequra nga përfaqësues të miratuar të një feje ose besimi të tillë, të ketë vizita nga përfaqësues të fesë apo besimit dhe të ketë në posedim libra ose literaturë që kanë të bëjnë me fenë ose besimet e tij.

9.3 I mituri nuk mund të detyrohet të praktikojë një fe, të ndjekë një besim, të marrë pjesë në shërbesa fetare, takime, praktika fetare ose të pranojë vizita nga përfaqësues të çdo feje apo besimi.

10. Kontakti me shoqërinë dhe komunitetin

10.1 Të miturit i lejohej komunikimi pa kufizim nëpërmjet letrave dhe, sa më shpesh të jetë e mundur, me telefon ose forma të tjera të komunikimit me familjet e tyre, persona të tjerë, përfaqësues të organizatave të jashtme dhe për të marrë vizita të rregullta nga këta persona.

10.2 Rregullimi i vizitave duhet të jetë i tillë që t'i lejojë të miturit të mbajë e të zhvillojë marrëdhëniet familjare në mënyrë sa më normale si dhe të ketë mundësi për riintegrim social.

10.3 Personeli i institucionit të kufizimit të lirisë duhet t'i ndihmojë të miturit në mbajtjen e kontakteve të përshtatshme me botën e jashtme dhe t'u sigurojë mjetet e duhura për ta bërë këtë.

10.4 Komunikimi dhe vizitat mund t'i nënshtrohen kufizimeve dhe monitorimit të domosdoshëm për kërkesat e hetimeve të vazhdueshme penale, të ruajtjes së rendit e sigurisë, parandalimit të veprave penale dhe mbrojtjes së viktimave të krimit, por kufizime të tilla, duke përfshirë edhe kufizime të urdhëruara nga gjykata, duhet të lejojnë një nivel minimal, të pranueshëm, kontakti.

10.5 Çdo informacion i marrë për vdekjen apo sëmundjen serioze të një të afërmi duhet t'i komunikohet menjëherë të miturit, në prani të psikologut ose punonjësit social.

10.6 Të miturit i lejohen periudha të rregullta lejeje, qoftë të shoqëruar ose vetëm, dhe mund t'i lejohej të largohet nga institucioni për arsye të ligjshme. Kohëzgjatja e kësaj lejeje nuk i kalon 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Në këtë kohë përfshihet edhe koha e nevojshme për udhëtim në familjen e tij ose në destinacion.

11. Paraqitja e ankesave



11.1 I mituri, prindërit ose të afërmit e tij duhet të kenë mundësi të mjaftueshme për të bërë kërkesa ose ankesa te drejtuesi i institucionit.

11.2 Procedurat për të bërë kërkesa ose ankesa duhet të jenë të thjeshta dhe efektive. Vendimet për këto kërkesa ose ankesa duhet të merren në një kohë sa më të shpejtë.

11.3 Prioritet për zgjidhjen e kërkesave apo ankesave i jepet zgjidhjes me ndërmjetësim, si një mënyrë për zgjidhjen e konflikteve.

11.4 Nëse refuzohet një kërkesë ose ankesë, ajo duhet të shoqërohet me arsyet përkatëse, duhet t'i komunikohet të miturit dhe, atje ku është e mundur, prindit ose të afërmit të tij, i cili e ka bërë atë. I mituri ose, kur është e mundur, prindërit apo i afërmi i tij, kanë të drejtën të ankohen në një autoritet të pavarur e të paanshëm.

11.5 Nëse ankesa ose kërkesa është me shkrim, autoritetet duhet të sigurojnë mundësi për të miturin që të dëgjohet personalisht.

11.6 Ndalohet penalizimi i të miturit për shkak të një kërkesë ose ankesë.

11.7 I mituri dhe prindi ose të afërmit e tij kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë ligjore lidhur me ankesat dhe procedurat e apelit.

12. Inspektimi dhe monitorimi

12.1 Veprimtaria e institucionit për kufizimin e lirisë inspektohet rregullisht, për të vlerësuar nëse detyrat e ushtruara janë në përputhje me ligjin dhe rregullimet e këtij vendimi.

12.2 Kushtet në institucion dhe trajtimi i të miturit me liri të kufizuar mund të monitorohen nga një institucion apo organizëm i pavarur.

12.3 Në monitorimet që kryhen nga institucioni apo organizmi i pavarur, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit të forcës, kufizimeve, dënimeve disiplinore dhe formave të tjera kufizuese të trajtimit.

12.4 Raportet e monitorimit i bëhen me dije strukturave drejtuese të sistemit penitenciar dhe Ministrisë së Drejtësisë.

13. Personeli i institucionit

13.1 Personeli i institucionit rekrutohet dhe përzgjidhet bazuar në procedurat që ndiqen për përzgjedhjen e personelit administrativ, sipas rregullave të Kodit të Punës.

13.2 Aftësitë profesionale të personelit duhet të forcohen e zhvillohen rregullisht, nëpërmjet

trajnimeve të vazhdueshme, mbikëqyrjes dhe rishikimeve të performancës dhe vlerësimeve.

13.3 Trajnimet duhet të përqendrohen në dhënien e njohurive lidhur me:

a) etikën dhe vlerat themelore të profesionit në fjalë;

b) mekanizmat mbrojtës kombëtarë dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe mbrojtjen e të miturve ndaj trajtimit të papranueshëm;

c) ligjet për të miturit dhe të drejtën familjare, psikologjinë e zhvillimit, punën sociale e arsimore me të miturit;

ç) udhëzimin e personelit se si të udhëheqin e motivojnë të miturit, të fitojnë respektin dhe të ofrojnë modele e perspektivë pozitive për të miturin;

d) krijimin dhe mirëmbajtjen e një marrëdhënieje profesionale me të miturit dhe familjet e tyre;

dh) metodat e provuara të ndërhyrjes dhe praktikat e mira;

e) metodat e trajtimit të diversitetit të të miturve në fjalë;

ë) mënyrat e bashkëpunimit në grupet shumëdisiplinare si dhe me institucionet e tjera të përfshira në trajtimin individual të të miturve.

III. RREGULLI DHE SIGURIA NË INSTITUCION

1. Rregulla të përgjithshme

1.1 Rregulli në institucion do të mbahet duke krijuar një mjedis të shëndetshëm e të sigurt, në të cilin të respektohen dinjiteti dhe integriteti fizik i të miturit me liri të kufizuar dhe përmbushen qëllimet kryesore të tyre zhvillimore.

1.2 Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së të miturve vulnerabël dhe parandalimit të viktimizimit.

1.3 Personeli duhet të zhvillojë aktivitete me qasje dinamike ndaj ruajtjes e sigurisë, duke u bazuar në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive me të miturin.

1.4 I mituri duhet të nxitet që të angazhohet individualisht e kolektivisht në mbajtjen e rregullit në institucion.

2. Kontrolli

2.1 Kontrolli i të miturit ushtrohet vetëm në rast nevojë dhe duhet të kryhet nga personeli i së njëjtës gjini. Ekzaminimet intime duhet të



justifikohen mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, në një rast specifik, dhe duhet të kryhen vetëm nga një mjek i specializuar.

2.2 Vizitorët mund të kontrollohen vetëm nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm se ata mund të kenë diçka në posedim të tyre, që kërcënon mirëqenien dhe sigurinë e të miturit në institucionin e kufizimit të lirisë.

2.3 Procedurat e detajuara të ushtrimit të kontrollit përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit të kufizimit të lirisë.

3. Përdorimi i forcës, kufizimi fizik dhe armët

3.1 Ndalohet të përdoret forca kundër të miturit nga personeli i institucionit të kufizimit të lirisë, përveçse si mjet i fundit për vetëmbrojtje ose në rastet e rrezikut të drejtpërdrejtë të vetëdëmtimit apo dëmtimit të të tjerëve.

3.2 Niveli i forcës së përdorur duhet të jetë minimumi i nevojshëm dhe të zbatohet për kohën më të shkurtër të mundshme.

3.3 Personeli i institucionit duhet të trajnohet në përdorimin e teknikave që mundësojnë shmangien apo përdorimin minimal të forcës së rastet e shfaqjes së sjelljes agresive.

3.4 Ndalohet përdorimi i prangave, me përjashtim të rastit kur janë të domosdoshme, si një masë paraprake kundër sjelljes së dhunshme.

3.5 Ndalohet përdorimi i instrumenteve kufizuese, duke përfshirë zinxhirët, hekurat dhe mjete të tjera poshtëruese.

3.6 Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i armëve nga personeli i institucionit të kufizimit të lirisë, me përjashtim të rasteve kur një urgjencë operacionale e dikton këtë.

4. Ndarja për arsye mbrojtjeje dhe sigurie

4.1 Një i mitur mund të ndahet nga të tjerët për arsye mbrojtjeje ose sigurie. Nevoja e ndarjes përcaktohet nga vlerësimi i punonjësit social, psikologu dhe mjeku i institucionit. Ndaj kësaj mase i mituri, prindi ose të afërmit kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë drejtuesit të institucionit dhe strukturave drejtuese të sistemit penitenciar.

4.2 Izolimi, si mjet për kufizim të përkohshëm, duhet të përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe vetëm për disa orë dhe, në çdo rast, nuk duhet të kalojë 24 (njëzet e katër) orë. Në rastet e izolimit duhet të njoftohet menjëherë mjeku, i cili duhet të mbikëqyrë

gjendjen e të miturit gjatë kohëzgjatjes së izolimit.

5. Masat disiplinore

5.1 Aplikimi i masave disiplinore është mekanizmi i fundit i zgjidhjes së një situatë të shkeljes së rregullave të institucionit të kufizimit të lirisë. Në rast të shkeljes së rregullave i jepet përparësi zgjidhjes restauruese të konflikteve dhe ndërveprimit edukativ, me qëllim vlefshmërinë e normës, në vend të seancave dhe dënimeve formale disiplinore.

5.2 Llojet e masave disiplinore janë:

a) tërheqje vëmendjeje;

b) kufizim, deri në 10 ditë, të përdorimit të sende të lejuara, me përjashtim të ushqimeve, mjeteve mësimore dhe mjekimeve të lejuara nga mjeku;

c) veçimi/ndarje, deri në 15 ditë, nga shoqërimi me të miturit e institucionit.

5.3 Përbën shkelje disiplinore vetëm sjellja që cenon sigurinë e mirëqenies së të miturve të tjerë.

5.4 I mituri që ka kryer një shkelje disiplinore duhet të informohet menjëherë, dhe me një mënyrë dhe gjuhë të qartë, që të kuptojnë natyrën e shkeljes së kryer. Ai ka të drejtë të dëgjohet dhe të mbrohet personalisht, vetë ose me ndihmën e prindërve apo të afërmeve të tij.

5.5 Masat disiplinore do të zgjidhen, për aq sa është e mundur, për qëllimin e tyre edukues.

5.6 Veçimi/ndarja, si masë disiplinore, do të vendoset vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kur i mituri shfaq sjellje të dhunshme. Ndarja duhet të jetë për një periudhë të shkurtër kohore, gjatë së cilës të miturit i garantohej komunikimi, aksesimi në lexim dhe ushtrimi në natyrë për, të paktën, një orë çdo ditë.

5.7 Periudha e ekzekutimit të masës disiplinore mbikëqyret nga personeli psikolog dhe mjeku i institucionit.

5.8 Masa disiplinore nuk duhet të përfshijë kufizime në kontaktet familjare ose vizitat.

IV. STANDARDET E PROGRAMEVE TË EDUKIMIT E TË REHABILITIMIT

1. Programet e edukimit

1.1 Programet hartohen për të nxitur zhvillimin e të miturve dhe pjesëmarrjen e tyre në to në mënyrë aktive.

1.2 Programet hartohen në përputhje me nevojat individuale të të miturve, duke marrë në konsideratë moshën, gjininë, sfondin shoqëror e



kulturor, fazën e zhvillimit, rrethanat dhe llojin e veprës së kryer. Programet duhet të bazohen në gjetjet dhe praktikat më të mira të fushës.

1.3 Programet, në institucionin e kufizimit të lirisë, duhet të synojnë arsimin, zhvillimin personal e shoqëror, trajnimin profesional, rehabilitimin dhe përgatitjen për lirim. Këto mund të përfshijnë:

- a) shkollimin;
- b) trajnimin profesional;
- c) punën dhe terapinë profesionale;
- ç) edukimin qytetar;
- d) aftësitë sociale dhe trajnimin e aftësive;
- dh) menaxhimin e zemërimit;
- e) trajtimin e varësive;
- ë) terapinë individuale dhe të grupit;
- f) edukimin fizik e sportiv;
- g) programet e drejtësisë restauruese dhe riparimin e dëmit të shkaktuar;
- gj) aktivitete krijuese, gjatë kohës së lirë;
- h) aktivitete jashtë institucionit, leje ditore dhe format të tjera lejeje;
- i) përgatitjen për lirim dhe kujdes pas lirim.

1.4 Për të miturin me liri të kufizuar hartohet dhe zbatohet një plan individual, ku renditen aktivitetet në të cilat ai do të marrë pjesë. Objektivi i planit individual është zhvillimi i aftësive të të miturit për të mundur riintegrimin në shoqëri dhe përfitimi i treguesve pozitivë të sjelljes së tij në komunitet, pas përfundimit të periudhës së kufizimit.

1.5 Plani individual zbatohet e përditësohet rregullisht, me pjesëmarrjen e të miturve dhe, për sa është e mundur, me prindërit ose të afërmit e tyre.

1.6 Programi duhet të përcaktojë zhvillimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete jashtë ambientit të institucionit dhe përfshirjen në shoqërinë e komunitetit. Drejtuesi i institucionit të kufizimit të lirisë merr masa që, në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve të pushteti vendor, të organizojnë aktivitete edukative, argëtuese e sociale, për nxitjen e angazhimit dhe të pjesëmarrjes së të miturve me kufizim lirie.

1.7 Të gjithë të miturit e privuar nga liria duhet të lejohen të ushtrohen rregullisht, për të paktën dy orë çdo ditë, nga të cilat, së paku, një orë duhet të jetë jashtë, nëse moti e lejon.

1.8 Institucioni i kufizimit të lirisë duhet të sigurojë punësim për të miturin dhe shpërblim të

arsyeshëm për punën e kryer. Në këtë rast, të miturit i paguhen sigurimet shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Programet e rehabilitimit

2.1 Të miturit, pas përfundimit të periudhës së kufizimit, i ofrohet mbështetje për rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në komunitet.

2.2 Programet e rehabilitimit përfshihen në planin individual dhe zbatohen në kohën e duhur, para lirim.

2.3 Drejtuesit e institucionit të kufizimit të lirisë marrin masat për të siguruar kthimin gradual të të miturit në shoqërinë e lirë. Masat përfshijnë dhënien e lejeve shtesë dhe lirim të pjesshëm ose të kushtëzuar, të kombinuar me mbështetje sociale efektive.

2.4 Programet e rehabilitimit duhet të mundësojnë:

- a) mbështetjen e të miturit për kthimin në familjen e tij ose në gjetjen e një familjeje kujdestare dhe lehtësimin në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore;
- b) gjetjen e strehimit;
- c) vazhdimin e arsimit e të trajnimit;
- ç) gjetjen e punësimit;
- d) referimin të shërbimet e duhura sociale e shëndetësore;
- dh) sigurimin e ndihmës dhe mbështetje ekonomike.

3. Programet e edukimit dhe të rehabilitimit për të miturit e grupeve të veçanta

3.1 Për të miturit me shtetësi të huaj:

a) zbatohen programe edukimi dhe rehabilitimi për përgatitjen e tyre për riintegrim në vendet e origjinës. Drejtuesi i institucionit merr masa që në bashkëpunim me institucionet kompetente të garantojnë mbështetjen e nevojshme të të miturit, deri në mbërritjen në vendin e tij të origjinës;

b) lejohen vizita të veçanta dhe forma të tjera komunikimi me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit të tij, për të shmangur izolimin e tyre social;

c) nëse nuk ka përfaqësim diplomatik ose konsullor duhet t'u lejohen lehtësira për të komunikuar me përfaqësuesin diplomatik të shtetit që merr përsipër interesat e tij ose autoritetin kombëtar apo ndërkombëtar, që ka mision për t'u shërbyer interesave të këtyre personave. Drejtuesi i institucionit siguron



bashkëpunimin e duhur të drejtuesve të tjerë të institucioneve në nivel vendor me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë, që përfaqësojnë të miturin, me qëllim plotësimin e nevojave të veçanta të tij.

3.2 Për të miturit, pjesë e pakicave etnike dhe gjuhësore;

a) zbatohen programe edukimi dhe rehabilitimi në gjuhën e tyre;

b) merren masa të posaçme për të ofruar kurse gjuhësore për ata që nuk zotërojnë mirë gjuhën zyrtare.

3.3 Për të miturit me aftësi të kufizuara:

a) sigurohen programe edukimi dhe rehabilitimi në përputhje me nevojat e tyre të veçanta;

b) merren masa për t'u vendosur në institucione të specializuara, ku këto nevoja mund të përmbushen.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të planifikojë në buxhetin e saj nevojat financiare për ngritjen dhe funksionimin e institucionit për kufizimin e lirisë për të miturit.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 235, datë 17.4.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 389, DATË 19.5.2010; NR. 378, DATË 25.5.2016; NR. 529, DATË 20.7.2016; NR. 563, DATË 29.7.2016; NR. 230, DATË 21.3.2017; NR. 711, DATË 1.12.2017; NR. 712, DATË 1.12.2017; NR. 713, DATË 1.12.2017; NR. 291, DATË 21.5.2018; NR. 294, DATË 21.5.2018; NR. 432, DATË 11.7.2018; NR. 433, DATË 11.7.2018; DHE NR. 737, DATË 12.12.2018, “PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE PËR SIPËRFAQET TAKUESE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3, të nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimet e mëposhtme të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Në lidhjen A, të vendimit nr. 389, datë 19.5.2010, në zonën kadastrale 8521, për pasurinë 13/14 zvogëlohet sipërfaqja e kompensimit.

2. Në lidhjen B, të vendimit nr. 378, datë 25.5.2016, në zonën kadastrale 8526, për pasurinë 383/1/29 (383/104) zvogëlohet sipërfaqja e kompensimit.

3. Në lidhjen C, të vendimit nr. 529, datë 20.7.2016, në zonën kadastrale 8526, për pasurinë 19/33 anulohet kompensimi.

4. Në lidhjen D, të vendimit nr. 563, datë 29.7.2016, në zonën kadastrale 1139, për pasurinë 341/1 zvogëlohet sipërfaqja e kompensimit.

5. Në lidhjen E, të vendimit nr. 230, datë 21.3.2017, në zonën kadastrale 8230, për pasurinë 6/974 shtohet një emër në listën e bashkëpronarëve.



6. Në lidhjen F, të vendimit nr. 711, datë 1.12.2017:

a) në zonën kadastrale 1604, për pasurinë 512/80 anulohet kompensimi;

b) në zonën kadastrale 8170, në pasurinë 3/264 shtohet një emër në listën e bashkëpronarëve;

c) në zonën kadastrale 8601, në pasurinë 35/144 shtohen dy emra në listën e bashkëpronarëve.

7. Në lidhjen G, të vendimit nr. 712, datë 1.12.2017:

a) në zonën kadastrale 8518, për pasurinë 24/108 anulohet kompensimi;

b) në zonën kadastrale 8180, për pasurinë 340/8 anulohet kompensimi.

8. Në lidhjen H, të vendimit nr. 713, datë 1.12.2017, në zonën kadastrale 2441, në pasurinë 3/12 korrigjohet emri i pronarit.

9. Në lidhjen I, të vendimit nr. 291, datë 21.5.2018, në zonën kadastrale 8527, në pasurinë 2276/1 shtohet një emër në listën e bashkëpronarëve.

10. Në lidhjen J, të vendimit nr. 294, datë 21.5.2018:

a) në zonën kadastrale 8527, në pasurinë 1421/2 shtohen një emër bashkëpronarësh;

b) në zonën kadastrale 1604, për pasurinë 12/249 korrigjohet numri pasurisë;

c) në zonën kadastrale 8230, në pasurinë 6/1004 shtohet një emër në listën e bashkëpronarëve.

11. Në lidhjen K, të vendimit nr. 432, datë 11.7.2018, në zonën kadastrale 8564, për pasurinë 7/1347 anulohet kompensimi.

12. Në lidhjen L, të vendimit nr. 433, datë 11.7.2018, në zonën kadastrale 8526, në pasurinë 327/1 shtohen dy emra në listën e bashkëpronarëve.

13. Në lidhjen M, të vendimit nr. 737, datë 12.12.2018, në zonën kadastrale 8320, për pasurinë 14/401 anulohet kompensimi.

II. Tabela nr. 1 i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III. Ngarkohen Agjencia e Trajtimit të Pronës dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

AGJENSIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE

LISTA PËR DISA NDRYSHIME NË V.K.M. NR. 389 DATË 19.05.2010; V.K.M. NR. 378, DATË 25.05.2016; V.K.M. NR. 529, DATE 20.07.2016; V.K.M. NR. 563, DATE 29.07.2016; V.K.M. NR. 230, DATË 21.03.2017; V.K.M. NR. 711, DATË 01.12.2017; V.K.M. NR. 712, DATË 01.12.2017; V.K.M. NR. 713, DATË 01.12.2017; V.K.M. NR. 291, DATË 21.05.2018; V.K.M. NR. 294, DATË 21.05.2018; V.K.M. NR. 432, DATË 11.07.2018; V.K.M. NR. 433, DATË 11.07.2018; V.K.M. NR. 737, DATË 12.12.2018; "PER SHPERBLIMIN E PRONAREVE, PER SIPERFAQET TAKUESE, TE PASURIVE TE PALUAJTSHME, PRONE PRIVATE, TE CILAT PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE."

ISHTE / BEHET	NR. B.PRONAREVE	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PRONAVE	QARKU	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA TAKUESE PER KOMPESIM (m²)	VLERA E TREGUT PER TRUALL (lek/m²)	VLERA E SHPERBLIMIT (lek)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
LIDHJA A											
V.K.M. nr. 389, datë 19.05.2010											
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8521											
ISHTE	18	ARIF	HAXHIYMER	KOÇANI	32	L. Konf. Labinotit Elbasan	8521	13/14	283.2	10,000	2,832,000
	19	& (TRASHEGIMTARET)									
BEHET	1	NADIJE	HAXHI	KOÇANI	1	Lagja "Konferenca Labinotit", Elbasan	8521	13/14	161.6	10,000	1,616,000
	2	ALEMSHA	HAXHI	KOÇANI							
	3	ARIF	HAXHI	KOÇANI							
	4	PETRIT	HAXHI	KOÇANI							
	5	BURBUQE	HAXHI	KOÇANI							
	6	MIMOZA	HAXHI	KOÇANI							
	7	SHEGUSH	HAXHI	KOÇANI							
	8	MIGENA	HAXHI	KOÇANI							



Shtojca nr. 1

ISHTE / BEHET	NR. B.PRONAREVE	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PRONAVE	QARKU	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA TAKUESE PER KOMPESIM (m²)	VLERA E TREGUT PER TRUALL (lek/m²)	VLERA E SHPERBLIMIT (lek)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
LIDHJA B											
V.K.M. nr. 378, datë 25.05.2016											
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526											
ISHTE	806	GEZIM	KAMER	MERKO	104	ELBASAN	8526	383/1/29	546.6	12,764	6,976,802.4
Behet	8	GEZIM	KAMER	MERKO	2	ELBASAN	8526	383/1/29 (383/104)	516.4	12,764	6,591,329.6
LIDHJA C											
V.K.M. nr. 529, datë 20.07.2016											
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1649											
ISHTE	528	FAIK		ALLUSHAJ	79	TIRANE	1649	19/33	195.4	324	63,309.60
BEHET		ANULLOHET			3	ANULLOHET			ANULLOHET		
LIDHJA D											
V.K.M. Nr. 563, date 29.07.2016											
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 1139											
ISHTE	455	MARK		GJONI	68	SHKODER	1139	341/1	365.0	293	106,945
BEHET	10	MARK		GJONI	4	SHKODER	1139	341/1	100.0	293	29,300



Shtojca nr. 1

KORRIGJIM	Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Gjendja juridike (pronesi)	Pjesa takuese në parcelë (m²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m²)	Kompensimi i Pronarëve							Seksioni i Veçantë	
		Emer	Atesi	Mbiemër	Leja e legalizimit					Emer	Atesia	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma (Vlera e kompensimit)		
					Numer	Date												
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	
LIDHJAE																		
VKM nr. 230, datë 21.03.2017																		
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8230																		
ISHTE		MEDI	XHEHAL	ZENELI	6178	26.04.2011				IBRAHIM		CULLHAJ	6/974	476.20	23,703	11,287,368.6		
		ISMAIL	MEHMET	STAFJA	70238	07.08.2015				SULTTANE		SHIMA						
											IDRIZ							CULLHAJ
											REXHIEP							CULLHAJ
											LUTFI							CULLHAJ
											SHERIF							CULLHAJ
											EMINE							SHIMA
											FATIME							CULLHAJ
											SADETE							CAUSHI
											HURMA							CULLHAJ
											VAJE							CULLHAJ
											RAMAZAN							CULLHAJ
											REFIK							CULLHAJ
											GEZIM							CULLHAJ
											SERVETE							KECI
											SANIJE							CULLHAJ
											ZONJE							SHKRETA
											SHPRESA							ISUFI
											FLUTURA							KAXHAJA
											KUJTIM							CULLHAJ
											MIMOZA							CULLHAJ
											ASTRIT							CULLHAJ
											MIRELA							CULLHAJ
											BARDHA							CULLHAJ
											HANE							CULLHAJ
											ARBEN							CULLHAJ
BEHET	18	MEDI	XHEHAL	ZENELI	6178	26.04.2011				IBRAHIM		CULLHAJ	6/974	476.20	23,703	11,287,368.6		
	19	ISMAIL	MEHMET	STAFJA	70238	07.08.2015				SULTTANE		SHIMA						
										IDRIZ		CULLHAJ						
										REXHIEP		CULLHAJ						
										LUTFI		CULLHAJ						
										SHERIF		CULLHAJ						
										EMINE		SHIMA						
										FATIME		CULLHAJ						
										SADETE		CAUSHI						
										HURMA		CULLHAJ						
										VAJE		CULLHAJ						
										RAMAZAN		CULLHAJ						
										REFIK		CULLHAJ						
										GEZIM		CULLHAJ						
										SERVETE		KECI						
										SANIJE		CULLHAJ						
										ZONJE		SHKRETA						

Page | 4541

										HALIL		KOKONOZI							
										HANKE		MATJA							
										HYSEN		KOKONOZI							
										INA		KOKONOZI							
										JAKUP		NAXHAKU							
										MIMOZA		KOKONOZI							
										NAIME		SHIJAKU							
										NAZMI		MANGJA							
										PRANVER		KOKONOZI							
										SAMI		KOKONOZI							
										VILMA		KOKONOZI							
										ZEQINE		KOKONOZI							
QARKU VLORE, ZVRPP VLORE, ZONA KADASTRALE 8601																			
ISHTE		HYSEN	ESAT	CAUSHAJ	101019	12.01.2015				SHIPETIM		HAXHIRAJ	35/144	1,272.11	10,903	13,869,815.33			
		AVDI	XHEJLAL	ZHOLI	101141	20.03.2015				ARNALDO		HAXHIRAJ							
		GEZIM	MUHARREM	ÇELA	103256	06.08.2015				BUJAR		HAXHIRAJ							
											NATASHA							HAXHIRAJ	
											SHIQIPONJE							(XHEJLAL) HAXHIRAJ	
BEHET		HYSEN	ESAT	CAUSHAJ	101019	12.01.2015				SHIPETIM		HAXHIRAJ	35/144	1,272.11	10,903	13,869,815.33			
		AVDI	XHEJLAL	ZHOLI	101141	20.03.2015				ARNALDO		HAXHIRAJ							
		GEZIM	MUHARREM	ÇELA	103256	06.08.2015				BUJAR		HAXHIRAJ							
											NATASHA							HAXHIRAJ	
											SHIQIPONJE							(XHEJLAL) HAXHIRAJ	
											SALUSHE	RESUL						HAXHIRAJ	
											XHEVAT	RESUL						HAXHIRAJ	
LIDHJA G																			
V.K.M. nr. 712, datë 26.12.2017																			
Qarku Dures, Bashkia Dures, Zona Kadastrale 8518, ZVRPP Dures																			
ISHTE	1	ALEKSANDER	BASHKIM	GUMENI	225822	08.12.2016	ME PRONAR		500	ALEKSANDER		TIRANA	24/108	500	19,336	9,668,000.0	M.E.V.GJYKATE NR. 515.DT. 27.07.2011. SI DIE V.GJ.FAKT		
										ANA		ALEKSI							
										DORETA		SHEDIA							
										ELIDA		NOCKA							
										MIKEL		NOCKA							
BEHET	1	ANULLOHET					ANULLOHET			ANULLOHET					ANULLOHET				
QARKU TIRANE , ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180																			
ISHTE		TAFIL	HAVZI	NUREDINAJ			TE TRETIVE		294.8	ABDYLL	IBRAHIM	BALI	340/8	294.8	256	754,688.0			
BEHET	2	ANULLOHET					ANULLOHET			ANULLOHET					ANULLOHET				
LIDHJA H																			
V.K.M. nr. 713, datë 01.12.2017																			
Qarku Elbasan, Bashkia Cerrik, ZVRPP Elbasan, Zona Kadastrale 2441																			
Ishte	625	BARDHUL	MEZAN	BAJRAMI	9985215	23/06/2016	PRONARE		21.3	MUSTAFA	ZHENEL	KURTI	3/12	369	419	154,611.0			
	626	YMER	NEXHIP	HYSA	9985213	23/06/2016	PRONARE		347.7	ÇELIGE	HYMER	KURTI							
										SHIPETIM	MUSTAFA	KURTI							
Behet	14	BARDHUL	MEZAN	BAJRAMI	9985215	23/06/2016	PRONARE		21.3	IBRAHIM	ABAZ	ÇELA	3/12	369	419	154,611.0			
	15	YMER	NEXHIP	HYSA	9985213	23/06/2016	PRONARE		347.7										



V.K.M. nr. 294, datë 21.05.2018															
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527															
ISHTE	1	SULEJMAN	AGRON	KUTROLI	99998879	6/11/2015			MUSTAFA	DILAVER	CANI	1421/2	924.20	12,764	11,796,488.8
	2	HASHIM	QAMIL	ADEMI	9925681	6/4/2015			KUTIM	EMIN	BAKALLI				
	3	XHEVAHIR	ALI	TERZIU	1124	8/5/2009			ZENEPE		SOJLI				
	4	ERMIR	RAMAZAN	BUDANI		2010			ELDA	ISUF	RABETA (BAKALLI)				
	5	OSMAN	ISMAIL	HOXHA	2024	2/10/2009			ARDIAN		CANI				
									BIHANE		BAKALLI				
									ALEMSHA	EMIN	CERRAGA (BAKALLI)				
									VJOLLCA	SEID	BAKALLI				
									BUJAR	EMIN	BAKALLI				
									SHEGUSH	YMER	BIÇOKU				
									MIRANDA	YMER	TOSKU				
									ARDIT	YMER	KUQI				
									SAIMIR	YMER	BAKALLI				
BEHET	7	SULEJMAN	AGRON	KUTROLI	99998879	6/11/2015			MUSTAFA	DILAVER	CANI	1421/2	924.2	12,764	11,796,488.8
	8	HASHIM	QAMIL	ADEMI	9925681	6/4/2015			KUTIM	ABDYI	BAKALLI				
	9	XHEVAHIR	ALI	TERZIU	1124	8/5/2009			DALIP	KADRI	BAKALLI				
	10	ERMIR	RAMAZAN	BUDANI		2010			ZENEPE		SOJLI				
	11	OSMAN	ISMAIL	HOXHA	2024	2/10/2009			ELDA	ISUF	RABETA (BAKALLI)				
									ARDIAN		CANI				
									BIHANE		BAKALLI				
									ALEMSHA	EMIN	CERRAGA (BAKALLI)				
									VJOLLCA	SEID	BAKALLI				
									BUJAR	EMIN	BAKALLI				
									SHEGUSH	YMER	BIÇOKU				
									MIRANDA	YMER	TOSKU				
									SAIMIR	YMER	BAKALLI				
									ARDIT	YMER	KUQI				
									ASTRIT	HYSEN	BAKALLI				
QARKU TIRANË, ZVRPP TIRANË, ZONA KADASTRALE 1604															
	13	MEHIDI	SHAQIR	BETI	2623057	16.12.2016	TE TRETËVE		BAKUSHE	KADRI	KOLA	12/249	417.0	33,755	14,075,835.0
								BUKURIE	KADRI	LUARI					
								DRITA	KADRI	BALLA					
								FADIL	KADRI	BALLA					
								HAMIT	KADRI	BALLA					
								KADRI	KADRI	BALLA					
								MEJREME	KADRI	SHERA					
								MYSLIM	KADRI	BALLA					
								SANIE	KADRI	BILANI					
	13	MEHIDI	SHAQIR	BETI	2623057	16.12.2016	TE TRETËVE		BAKUSHE	KADRI	KOLA	14/249	417.0	33,755	14,075,835.0
								BUKURIE	KADRI	LUARI					
								DRITA	KADRI	BALLA					
								FADIL	KADRI	BALLA					
								HAMIT	KADRI	BALLA					
								KADRI	KADRI	BALLA					
								MEJREME	KADRI	SHERA					
								MYSLIM	KADRI	BALLA					
								SANIE	KADRI	BILANI					
QARKU TIRANË, ZVRPP TIRANË, ZONA KADASTRALE 8230															
Ishte		ILJAZ	HYQMET	ALIBISI	NR. 2623558	24/03.2017	TE TRETËVE		IBRAHIM		CULLHAJ	6/1004	397.00	23,703.0	9,410,091.00
								SULTANE		SHIMA					
								IDRIZ		CULLHAJ					
								REXHEP		CULLHAJ					
								LUTFI		CULLHAJ					



									SHERIF		CULLHAJ																		
									EMINE		SHIMA																		
									FATIME		CULLHAJ																		
									SADETE		CAUSHI																		
									HURMA		CULLHAJ																		
									VAJE		CULLHAJ																		
									RAMAZAN		CULLHAJ																		
									REFIK		CULLHAJ																		
									GEZIM		CULLHAJ																		
									SERVETE		KECI																		
									SANIJE		CULLHAJ																		
									ZONJI		SHKRETA																		
									SHIPRESA		ISUFA																		
									FLUTURA		RAXHAJA																		
									KUJTIM		CULLHAJ																		
									MIMOZA		CULLHAJ																		
									ASTRIT		CULLHAJ																		
									MIRELA		CULLHAJ																		
									BARDHA		CULLHAJ																		
									HANE		CULLHAJ																		
									ARBEN		CULLHAJ																		
BEHET	17	ILJAZ	HYQMIET	ALIBISI	2625558	24/03.2017	TE TRETETEVE		IBRAHIM		CULLHAJ	6/1004	397.00	23,703.0	9,410,091.00														
									SULTANE		SHIMA																		
									IDRIZ		CULLHAJ																		
									REXHEP		CULLHAJ																		
									LUTFI		CULLHAJ																		
									SHERIF		CULLHAJ																		
									EMINE		SHIMA																		
									FATIME		CULLHAJ																		
									SADETE		CAUSHI																		
									HURMA		CULLHAJ																		
									VAJE		CULLHAJ																		
									RAMAZAN		CULLHAJ																		
									REFIK		CULLHAJ																		
									GEZIM		CULLHAJ																		
									SERVETE		KECI																		
									SANIJE		CULLHAJ																		
									ZONJI		SHKRETA																		
									SHIPRESA		ISUFA																		
									FLUTURA		RAXHAJA																		
									KUJTIM		CULLHAJ																		
									MIMOZA		CULLHAJ																		
									ASTRIT		CULLHAJ																		
									MIRELA		CULLHAJ																		
									BARDHA		CULLHAJ																		
									HANE		CULLHAJ																		
									ARBEN		CULLHAJ																		
									VJOLLCA		TROPLINI (CULLHAJ)																		
LIDHJA K																													
V.K.M. nr. 432, datë 11.07.2018																													
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8564																													
ISHTE	82	Myrto	Feti	Ibro	110784	18/08/2015	Te treteve	204	Servete	Figjini	Dymshillari	7/1347	204.00	8,537	1,741,548.0	Diference sipërfaqe me objektet e shitura nga shiteti jane brenda sip.se pengjithshme.													



										Fedane	Fiqin	Qori						
										Minjeta	Fiqin	Qori						
										Diana	Fiqin	Qori						
										Asllan	Fiqin	Qori						
										Perpunim	Fiqin	Qori						
										Bukune	Fiqin	Qori						
										Mesure	Fiqin	Qori						
BEHET	6	ANULLOHET				ANULLOHET		ANULLOHET			ANULLOHET			ANULLOHET				
LIDHJAL																		
V.K.M. nr. 433, datë 11.07.2018																		
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526																		
ISHTE	66	SAIMIR	NEZIR	BEQIRI	8856324	28/06/2016	PRONAR		232.5	HEDHJE		LEKA	327/1	700.2	12,764	8,937,352.8		
		SAIMIR	NEZIR	BEQIRI	8856323	28/06/2016	PRONAR		467.7	XHULJETA		LEKA (TREPSENISHITI)						
										ARBANA		LEKA (GRECA)						
										CENO		METUSHI						
										EDIS	CENO	METUSHI						
										SABRIJE		VOGLI						
										KAROLDA	ALI	VOGLI						
										MIRELA	ALI	DOCI						
										MERTITA	BESIM	IPEKU						
										ARDJAN	MEHMET	IPEKU						
										LUELDA	RAMIZ	IPEKU						
										MEHMET		IPEKU						
										FATMIRA	XHAFERR	IPEKU						
										ILIRJAN	REXHEP	LEKA						
										ALI	MUSTAFA	SUBASHI						
										ISMAIL	MUSTAFA	SUBASHI						
										ALEM SHA		SUBASHI						
										MANUSHAQE		SUBASHI						
										NEXHMIJE		SUBASHI						
										SUZANA		SUBASHI						
										NAZMI		SUBASHI						
										FATUSHIE		SUBASHI						
										DURIM		SUBASHI						
										SHIPRESA		SUBASHI						
										ERMIRA		SUBASHI						
										BESA		SUBASHI						
BEHET	4	SAIMIR	NEZIR	BEQIRI	8856324	28/06/2016	PRONAR		232.5	HEDHJE		LEKA	327/1	700.2	12,764	8,937,352.8		
	5	SAIMIR	NEZIR	BEQIRI	8856323	28/06/2016	PRONAR		467.7	XHULJETA		LEKA (TREPSENISHITI)						
										ARBANA		LEKA (GRECA)						
										CENO		METUSHI						
										EDIS	CENO	METUSHI						
										SABRIJE		VOGLI						
										KAROLDA	ALI	VOGLI						
										MIRELA	ALI	DOCI						
										MERTITA	BESIM	IPEKU						
										ARDJAN	MEHMET	IPEKU						
										LUELDA	RAMIZ	IPEKU						
										MEHMET		IPEKU						



										FATMIRA	XHAFFERR	IPEKU							
										ILIRJAN	REXHEP	LEKA							
										ISMAIL	MUSTAFA	SUBASHI							
										ALI	MUSTAFA	SUBASHI							
										ALEMISHA		SUBASHI							
										MANUSHHAQE		SUBASHI							
										NEXHMIJE		SUBASHI							
										SUZANA		SUBASHI							
										NAZMI		SUBASHI							
										FATUSE		SUBASHI							
										DURIN		SUBASHI							
										SHIPRISA		SUBASHI							
										ERMIRA		SUBASHI							
										BESA		SUBASHI							
										EDMOND	REXHEP	LEKA							
										ALI	XHEMALI	VOGLI							
LIDHJAM																			
V.K.M. nr. 737, datë 12.12.2018																			
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8320, ZVRPP TIRANE																			
ISHITE		CEJNIK	SKENDER	SEKNDERI	997478	22/05/2017	E të Tretëve			FADIL	SHAHIN	HAMITI							
										RABIJE	SHAHIN	HAMITI							
										NADIRE	SHAHIN	HAMITI							
										FATMIR	SHAHIN	HAMITI							
										GJYLE	SHAHIN	HAMITI							
										NAFIJE	SHAHIN	HAMITI							
										SERVETE		HAMITI							
										MIMOZA	XHEMAL	HAMITI							
										XHEVAHIRE	XHEMAL	HAMITI							
										FLORESHA	XHEMAL	HAMITI							
										VLADIMIR	XHEMAL	HAMITI							
										ADFLINA		HAMITI							
										KLOTILDA	RAJMOND	HAMITI							
										KLODJAN	RAJMOND	HAMITI							
										FATOS	QEMAL	HAMITI							
										MANUSHHAQE	QEMAL	HAMITI							
										FELLËNXE	QEMAL	HAMITI							
										ALMA	QEMAL	SULAJ							
										FLAMUR	QEMAL	HAMITI							
										ÇLIRIM	AGIM	HAMITI							
										ROLAND		HAMITI							
										ENKELIJDIA	KASEM	ZYBERI							
										XHUME		HAMITI							
										MYHYRIJE	SABRI	CORJA							
										SULTANE	SABRI	HAMITI							
										GANIMETE	SABRI	HAMITI							
										DALLENDYSHE	SABRI	HAMITI							
										ARBEN	SABRI	HAMITI							
										HAZBI	SABRI	HAMITI							
										RABIJE		HAMITI							
										ADRIANA	SKENDER	HAMITI							
										LEONORA	SKENDER	HAMITI							
										FATJON	SKENDER	HAMITI							
BEHET		ANULLOHET								ANULLOHET				ANULLOHET					



VENDIM
Nr. 236, datë 17.4.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PULPËN E FRUTËS SË THATË
BAOBAB, SI PËRBËRËS I RI
USHQIMOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për pulpën e frutës së thatë baobab, si përbërës i ri ushqimor”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE
PËR PULPËN E FRUTËS SË THATË
BAOBAB SI PËRBËRËS I RI USHQIMOR¹

I. PËRKUFIZIME

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Frutë e thatë baobab” është frutë e baobabit, nga i cili, pjesa më e madhe e përmbajtjes së ujit origjinal është hequr natyrshëm, nëpërmjet tharjes në diell.

2. “Pulpë e frutës” është pjesa e butë, e shijshme e një frute që zakonisht është e përbërë nga mesokarpi.

3. “Pulpa e frutit të thatë baobab” është pulpa e frutës së baobabit, e thatë, e butë, me ngjyrë krem, që rrethon farën brenda guaskës.

II. ETIKETIMI

Në etiketën e produktit, që përmban përbërësin e ri ushqimor, në listën e përbërësve do të shënohet përcaktimi “Pulpë e frutës së thatë baobab”.

III. SPECIFIKIMET E PULPËS SË FRUTËS SË THATË BAOBAB

Përshkrimi

Fruta e baobabit është natyralisht e dehidratuar. Ai rritet në pemën afrikane baobab dhe është i mbështjellë në një guaskë të trashë. Pulpa e frutës baobab është e bardhë dhe grumbullohet rreth farave e fibrave të kuqe, brenda guaskës.

Frutat baobab (*Adansonia digitata*) mblihen nga pemët. Guaskat çahen për t’u hapur dhe prej aty nxirret tulli i frutës, duke lënë mënjanë farat dhe lëvozhgën. Tulli bluhet, ndahet në pjesë të mëdha dhe të trasha (madhësia e grimcave 3 deri 600 µ) dhe paketohe.

A. Treguesit tipikë ushqyes të pulpës së frutës së thatë baobab

Lagështira (humbja në tharje) (g/100 g)	11,1–12,0
Proteina (g/100 g)	2,03–3,24
Yndyra (g/100 g)	0,4–0,7
Hiri (g/100 g)	5,5–6,6
Karbohidratet totale (g/100 g)	78,3–78,9
Sheqeri total (si glukozë)	16,9–25,3
Natriumi (mg/100 g)	7,42–12,2

B. Specifikimet analitike

Lënda e huaj	Jo më shumë se 0.2 %
Lagështira (humbja në tharje) (g/100 g)	11,1–12,0
Hiri (g/100 g)	5,5 -6,6

¹ Kjo rregullore është përafëruar pjesërisht me:

vendimin e Komisionit 2008/575/EC të 27 qershorit 2008 mbi autorizimin dhe vendosjen në treg të pulpës së frutës së thatë baobab si një përbërës i ri ushqimor, sipas rregullore (EC) nr. 258/97 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; CELEX 32008D0575; FZ L 183, 11.7.2008, f. 38



VENDIM
Nr. 237, datë 17.4.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 712, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR TË DREJTËN E PESHKIMIT NË UJËRAT E BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 52, pika 3, e 30, pika 7, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore”.

2. Në pikat 1; 4, shkronjat “a” e “b”; 5; 12; 13 dhe 18, pas fjalëve “... ujërat e brendshme ...” shtohen “... për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese dhe për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore ...”.

3. Në pikën 2, pas fjalëve “... të brendshme ...” shtohen “... dhe atyre detare ...”.

4. Pas pikës 5/1 shtohet pika 5/2, me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“5/2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, para publikimit të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe për zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore, duhet të marrë miratimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kur zona objekt konkurrimi gëzon statusin si zonë e mbrojtur.”.

5. Në pikën 6, fjalët “... ujërat e brendshme për ...” hiqen.

6. Pika 10/1 e vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10/1. Subjektet e interesuara, që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e peshkimit në ujërat e brendshme, për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe për zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore, duhet të pajisen me leje, e cila përfshihet në nënkategorinë “të gjitha përdorimet e tjera (peshkim në ujërat e brendshme, peshkim nga organizatat e bashkëmenaxhimit (OMP) dhe dhënien në administrim të lagunave dhe zonave të tjera ujore limitrofe”, me kodin III.5.A.2.”.

7. Në shkronjën “A”, të pikës 11, pas paragrafit “-Për ujëmbledhësit e bujqësisë” shtohen edhe :

“- Për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese;

- Për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore;”.

8. Në pikën 19, fjalët “... për të gjitha kategoritë ujore në ujërat e brendshme ...” hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 238, datë 17.4.2019

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË KRYETARIT TË QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Eduart Makri emërohet kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**VENDIM****Nr. 178, datë 18.4.2019**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
DEMOKRATIKE, QARKU
GJIROKASTËR, PËR PLOTËSIMIN E
VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA
KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 18.4.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Gjirokastrë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Tritan Masar Shehu.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjoncaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Gjirokastrë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të

Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 1 (një) mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Gjirokastrë, është z. Tritan Masar Shehu.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Gjirokastrë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mospasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjorbë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë, duhet të zbatojë dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Gjirokastrë, i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 6 (gjashtë), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 96 datë 27.3.2019, ka vendosur, të shpallë



moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor kandidati vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumëmemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Gjirokastrë, është kandidati me numër rendor 7 (shtatë) znj. Fatjona Koço Dhimitri.

Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 7 (shtatë), znj. Fatjona Koço Dhimitri.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 1884 prot., datë 28.3.2019, znj. Fatjona Koço Dhimitri, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit, nëpërmjet njoftimit publik, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Znj. Fatjona Koço Dhimitri, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 9.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2131, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të znj. Fatjona Koço Dhimitri, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,

emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2286 prot., datë 10.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2285 prot., datë 10.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për Deputet, qarku Gjirokastrë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Fatjona Koço Dhimitri.

KQZ, gjithashtu ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1059/1 prot., datë 11.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Gjirokastrë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Fatjona Koço Dhimitri, sipas së cilës rezulton se është e padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Fatjona Koço Dhimitri, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës të listës shumëmemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, i renditur me numër rendor 7 (shtatë), znj. Fatjona Koço Dhimitri.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Gjirokastrë, znj. Fatjona Koço Dhimitri.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM
Nr. 179, datë 18.4.2019

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
DEMOKRATIKE, QARKU KORÇË,
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS
SË NJOFTUAR NGA KUVENDI
I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.4.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për dhënien e mandatis të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, Qarku Korçë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Hekuran Bujar Hoxhalli.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Korçë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatis të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatis, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Korçë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 4 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Korçë, janë numri rendor 1 (një) znj. Valentina Pandi Duka, me numër rendor 2 (dy) z. Ervin Bujar Salianji, me numër rendor 3 (tre) z. Hekuran Bujar Hoxhalli, me numër rendor 4 (katër) z. Klevis Fahri Balliu.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Korçë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjorbë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë ndaj Partisë Demokratike.



Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në Zonën Zgjedhore Qarku Korçë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, Qarku Korçë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 9 (nëntë), 11 (njëmbëdhjetë), 5 (pesë), 6 (gjashtë), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 74, 81 datë 20.3.2019, vendimi nr. 97, datë 27.3.2019 ka vendosur, të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 62, datë 12.3.2019 ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Ligoraq Jorgji Karamelo, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Ervin Bujar Salianji.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Korçë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 7 (shtatë), 8 (tetë), 10 (dhjetë), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 129, datë 9.4.2019 dhe vendimi nr. 147, datë 11.4.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si

rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 136, datë 9.4.2019 ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Arlind Engjell Çaçani, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Valentina Pandi Duka.

Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), 13 (trembëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 12 (dhjetë), z. Andi Petraq Përmeti.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2287 prot., datë 10.4.2019, z. Andi Petraq Përmeti, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Andi Petraq Përmeti, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 11.4.2019, formularin e vetdeklarimit me numër unik 2133, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetdeklarimit, të z. Andi Petraq Përmeti, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,



emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2341 prot., datë 12.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2340 prot., datë 12.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Andi Petraq Përmeti.

KQZ-ja, gjithashtu ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1086/1 prot., datë 15.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Andi Petraq Përmeti, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat Shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Andi Petraq Përmeti, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatin të radhës të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Korçë, i renditur me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), z. Andi Petraq Përmeti.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatin të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, z. Andi Petraq Përmeti.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM

Nr. 180, datë 18.4.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU BERAT, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 18.4.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatis të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatin të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Nasip Qani Naço.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Berat.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 2 (dy) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Berat, janë numri rendor 1 (një) z. Nasip Qani Naço dhe numri rendor 2 (dy) z. Gledion Tomorr Rehovica.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Gledion Tomorr Rehovica, deputet i zonës zgjedhore Qarku Berat, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 6, datë 15.1.2018 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Silva Maksim Caka.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave me shkresën nr. 729/1, datë 25.2.2019, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Berat, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumëmemërore me numër rendor 4 (katër), 8 (tetë), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 82, datë 20.3.2019 dhe vendimi nr. 93, datë 27.3.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetdeklarimit brenda afatit ligjor.

Ne bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumëmemërore me numër rendor 5 (pesë), 6 (gjashtë), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 6 (gjashtë), z. Eugen Dhimo Bojaxhiu.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 1888 prot., datë 28.3.2019, z. Eugen Dhimo Bojaxhiu, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Eugen Dhimo Bojaxhiu, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 9.4.2019, formularin e vetdeklarimit me numër unik 2132, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetdeklarimit, të z. Eugen Dhimo Bojaxhiu, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.



Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2286 prot., datë 10.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2285 prot., datë 10.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Berat, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Eugen Dhimo Bojaxhiu.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1059/1 prot., datë 11.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Berat, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Eugen Dhimo Bojaxhiu, sipas së cilës rezultoi se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Eugen Dhimo Bojaxhiu, rezultoi se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet në zonën zgjedhore qarku Berat, i renditur me numër rendor 6 (gjashtë), z. Eugen Dhimo Bojaxhiu.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në

listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, Qarku Berat, z. Eugen Dhimo Bojaxhiu.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM Nr. 181, datë 18.4.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 18.4.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, znj. Grida Agim Shqina (Duma).

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr.792/1prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 11 (njëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, Qarku Tiranë, janë numri rendor 1 (një) z. Lulzim Xhelal Basha, me numër rendor 2 (dy) znj. Orjola Hysni Pampuri, me numër rendor 3 (tre) znj. Rudina Azem Hajdari, me numër rendor 4 (katër) znj. Grida Agim Shqina (Duma), me numër rendor 5 (pesë) znj. Albana Sadik Vokshi, me numër rendor 6 (gjashtë) znj. Jorida Hasan Tabaku, me numër rendor 7 (shtatë) z. Sali Ram Berisha, me numër rendor 8 (tetë) z. Halim Marsut Kosova, me numër rendor 9 (nëntë) z. Gent Hysen Strazimiri, me numër rendor 10 (dhjetë) z. Fatmir Ali Mediu, me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Dashamir Hamit Shehi.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës

shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, në Zonën Zgjedhore qarku Tiranë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumëmemërore me numër rendor 22 (njëzet e dy), 23 (njëzet e tre), 24 (njëzet e katër), 36 (tridhjetë e gjashtë), 37 (tridhjetë e shtatë), 39 (tridhjetë e nëntë), 42 (dyzet e dy), 47 (dyzet e shtatë), 49 (dyzet e nëntë), 12 (dymbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 54, 55, 56, 57, datë 12.3.2019, vendimi 70, datë 20.3.2019, si dhe vendimet nr. 101, 103, 104, 105, datë 27.3.2019 ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin 45, datë 11.3.2019 ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit znj. Majlinda Skënder Halilaj, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Lulzim Xhelal Basha.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumëmemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumëmemërore me numër rendor 13 (trembëdhjetë), 14 (katërmëdhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), 17



(shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), 19 (nëntëmbëdhjetë), 20 (njëzet), 21 (njëzet e një).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet 115, 116, 120, 121, datë 4.4.2019 dhe vendimin nr. 165, datë 16.4.2019 ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin 125 datë 4.4.2019 ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Korab Qamil Lita, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Orjola Hysni Pampuri.

Në bazë të nenit 164 pika 2 e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 25 (njëzet e pesë), 26 (njëzet e gjashtë), 27 (njëzet e shtatë), 28 (njëzet e tetë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet 157, 158, 159, datë 16.4.2019 ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për Deputet me numër rendor 26 (njëzet e gjashtë), z. Erion Hysen Piciri.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2199 prot., datë 5.4.2019, z. Erion Hysen Piciri, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Erion Hysen Piciri, referuar ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 15.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2134, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Erion Hysen Piciri, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2382 prot., datë 16.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2383 prot., datë 16.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Erion Hysen Piciri.

Me shkresën nr.3540/1 prot. datë 6.7.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mbi verifikimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit politik Partia Demokratike, njofton se subjekti ka këto ndryshime në gjenealitetet e mëparshme, të padeklaruara në formularët e vetëdeklarimit:

Mbiemrin e ka korrigjuar nga “Nasi” në “Piciri” me datën 17.11.2009.

Të dhënat e evidentuara në të dy formularët e vetëdeklarimit janë të njëjtë dhe nuk kanë ndryshime.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1121/1 prot., datë 17.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e



Shqipërisë, z. Erion Hysen Piciri, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat Shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Erion Hysen Piciri, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës të listës shumëmemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 26 (njëzet e gjashtë), z. Erion Hysen Piciri.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2, neni 175 pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, z. Erion Hysen Piciri.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 476 lekë